- por integrimi ekonomik nuk ka akoma pamjen e nje TREGU vertete te mirefillte, pasi levizjet e kursit TE KEMBIMIT dhe rreziku i shkembimit mund te krijojne te tjera barriera per tregtine , dhe te kufizojne tregun financiar dhe krijimin e siper marrjeve ne vende ku faktoret e perodhimit duken te jene me te pershtatshem per aktivitetet e tyre .
- per kushte me optimale duhet nje etape tjeter --- krijimi i nje monedhe te perbashket si dhe harmonizimi i politikave ekonomike.
- per kete sherben marreveshja e Mastritit .



- ❑ Pas ketij hapi vazhdon hovi evropian me kalimin ne fazen e dyte ne ***bashkimin ekonomik dhe monetar.***



- **Koncepti baze eshte ky, nuk mund te eleminosh cdo pengese per shkembimet nese nuk ekziston nje stabilitet monetar I garantuar nga raporte fikse shkembimi ose me mire akoma nga monedha unike.**

- *Ne fakt ekzistonte nje SME (sistem monetar evropian) qe ecte mire, por a do te vazhdonte keshtu me zbatimin e plote te parimit te lirise se kapitaleve ?*

- **U hodh ideja e krijohej nje monedhe unike evropiane e drejtuar nga Banka Qendrore Evropiane.**



- Keshtu lindi ideja e thirrjes se nje Konference nderqeveritare mbi bashkimin evropian qe u aprovua nga Keshilli Evropian I Strasburgut 1989. (renia e murit te Berlinit).



- Ndersa ne Keshillin Evropian te Danubit (qershor 1990) u vendos te trajtohej paralel projekti i ri i per t'i dhene Evropes nje politike te jashtme te sigurise se perbashket si dhe ceshtjen e bashkimit monetar.
- Kunder ketyre dy programeve lufton zonja Thecher e cila ishte kundra krijimit te nje monedhe te perbashket. (not in my lifetime).

Krijimi i tregut te perbashket !



- **Nderkohe qe realizimi I programeve te caktuara nga Akti Unik Evropian ecte me ritem te kenaqem; direktivat e librit te bardhe I miratuan perfundimisht nga Keshilli dhe hyne ne fuqi dhe per shtetet anetare.**
- **Qarkullimi i lire i kapitaleve u realizua me 1 korrik 1990 dhe u kalua ne fazen e pare te krijimit te Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.**
- **Ne Summit Evropian te Maastricht (date 10 dhjetor 1991)u vendos miratimi I Traktatit te Maastricht i cili u perfundua ne javet e mepashme dhe u nenshkrua ne 7 shkurt te vitit 1992.**



- **Akti Unik Evropian I nenshkruar ne 1986 dhe I hyre ne fuqi ne 1 korrik 1987 u frymezua nga punet e Komitetit Dooge (komitet per ceshtjet institucionale i krijuar nga keshilli evropian).**
- **U fol per rishikimin e pare te vertete te traktateve te Romes dhe te Parisit, Progreset jane te konsiderueshme.**





- **Zhvillimet me te rendesishme prej tyre ne kuadrin e Aktit Unik Evropian jane:**
- **1) *vendos ekzistencen e Keshillit Evropian(summitit te krereve te shteteve)***
- **2) *I jep nje impuls te ri dhe vendimtar arritjes se tregut te brendshem (realizimi I lirise se qarkullimit te mallrave, te personave, te sherbimeve, te kapitaleve), ky objektiv eshte po ai I traktatit te KEE, por AUE I lehteson kushtet e realizimit, duke krijuar nje baze juridike te re (neni 100).***
- **3) *pergjitheson parimin e delegimit te pushteteve te ekzekutivit nga Keshilli tek Komisioni***



- 4) jep konceptin e ri te “*lidhjes ekonomike dhe shoqerore*”, zgjeron kompetencat komunitare per kerkim te zhvillimit teknologjik dhe per ambientin , fut dispozita te reja per ceshtjet shoqerore.
- 5) krijon nje procedure bashkepunimi te Parlamentit Evropian; zgjeron proceduren e konsultimit te PE; parashikon mendimin pro ne fushen e pjesemarrjes se nenshkrimit e Traktatit dhe marreveshje asociimit.



- **6) e ben aftesine vendimmarrese te Keshillit me efikase duke zgjeruar perdorimin e shumices se cilesuar.**
- **7) parashikon krijimin e Gjykates se Shkalles se Pare per te lehtesuar rolin e Gjykates dhe forcuar efikasitetin dhe cilesine e kontrollit gjyqesor**



- Perpara perfundimit te plote te fazes se integrimimit , shtetet antare do te kene zhvilluar aq shume lidhje politike dhe ekonomike midis tyre saqe do te ndjejne nevojen qe te njehesojne politikat e tyre jo-ekonomike: **politiken e brendshme dhe gjyqesore** , per te mbrojtur me me efikasitet kufijte e jashtem .
- **politikat e jashtme** , qe te jene nje gjigand ekonomik ne rraport me te tjeret
- Dhe me pas nje kat tjetër ai I **integrimimit Politik** , I cili mund te zhvillohet me tej ne drejtim te integrimimit te ngushte social dhe kulturor te njerezve , dikur te ndare prej kufijve .



Leksion 5

Traktati i Mاستrihtit

vazhdon...

Traktati i Mastrihtit



Traktati i Maastricht 1992



Përshpejtoi këtë proces
integrimi me krijimin e
Bashkimit European.

BE parashikon si organ të
tijin *Këshillin european* dhe
përbëhet nga tri pjesë ose
“shtylla mbështetëse” (baza);

Traktati i Maastricht 1992



1) baza *komunitare*, e cila bashkon tre Komunitete e mëparshme;

- a) KEE shndërrohet në Komunitetin europian dhe parashikohet
- “*nënshtetësia europiane*”
- b) Shtohen sektorët e rinj të mbrojtjes së shëndetit, të mbrojtjes së konsumatorit, të kulturës, të zhvillimit të rrjeteve transeuropiane, të industrisë, të mbrojtjes civile dhe të turizmit.
- c) Parashikohet Bashkimi ekonomik dhe monetar.

Traktati i Maastricht 1992



- 2) baza e *politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët (PESC)*; I takonte Këshillit, mbi bazën e orientimeve të Këshillit europian, të ndërmernte veprime të përbashkëta për çështjet.

Traktati i Maastricht 1992



- *3) baza e kooperimit në sektorët e drejtësisë dhe në çështjet e brendshme (GAI);* përfshinte politikën e strehimit dhe të imigrimit, luftën kundër toksikodipendencës dhe kundër mashtrimit në shkallë ndërkombëtare, kooperimin (bashkëpunimin) gjyqësor për çështjet civile dhe penale, kooperimin doganor dhe atë të policisë kundër terrorizmit dhe trafikut të drogës.

Nje analize e Traktatit te Maastrichtit !



- **Traktati perbehet nga:**
- **18 protokolle**
- **33 deklarata.**
- **Dispozitat organizohen ne 7 “tituj” dhe renditen me germa te alfabetit.**



- I Taktatit të Maastricht shpall se shtetet anetare përbejnë mes tyre një Bashkim Evropian.
- *Termi bashkim në fakt nuk shpreh kalimin në fazë federale, por është me shumë një kompromis mes sloganeve të leshuar në sfondin e ngjarjeve të mëdha që u fol nga Kancelari Kohl për “objektiva federale”, presidenti “Mitterrand për “shtete të bashkuara të Evropës” dhe M. Thacher për “një zonë shkëmbimi të lire”*

Titulli i dyte:



- permban normat qe modifikojne *Traktatin themelues* te KEE *per te krijuar Komunitetin Evropian* dhe pikerisht shprehja “*Komunitet ekonomik Evropian*” zevendesohet nga shprehja *Komunitet Evropian*,
- I jep karakter zyrtar *parimit te subsidiaritetit*, (subvencionim, mbeshtetje, plotesim)



- **Hyn ne fuqi nje dispozite e re e cila percakton si me poshte mbeshtetjen**
- **(Neni 5 I traktatit te KE) “Komuniteti vepron ne kufijte e kompetencave te dhena dhe te objektivave te caktuara nga ky Traktat.**
- *Ne fusha qe nuk bejne pjese ne kompetencen e tij ekskluzive, komuniteti vepron ne perputhje me parimin e Subsidiaritetit, vetem ne qofte se dhe per aq sa objektivat e veprimit te propozuar nuk mund te arrihet ne menyre te mjaftueshme nga Shtetet antare dhe prandaj per shkak te shkalles ose te pasojave te veprimit te propozuar, mund te permbushen me mire nga Komuniteti.*
- *Asnje veprim I Komunitetit nuk duhet te shkoje pertej asaj qe eshte e nevojshme per permbushjen e objektivave te ketij Traktati”.*
- **Ne sektoret qe nuk jane ne kompetencen e vet ekskluzive**



- Komuniteti nderhyn sipas parimit te mbeshtetjes vetem nese dhe per masen qe objektivat e veprimit te parashikuar nuk mund te realizohen ne shkalle te mjaftueshme nga shtetet anetare dhe qe munden per arsye te permasave te ndryshme te realizohen me mire ne nivel komunitar.

Themelon qytetarine evropiane



- Parashikon mbrojtjen diplomatike dhe konsullore per qytetaret e Bashkimit Evropian nga ana e shteteve te tij anetare dhe territorin e vendeve te treta ku shteti i qytetarise nuk eshte i perfaqesuar dhe parashikon nje te drejte peticioni perpara Parlamentit Evropian si dhe drejtimin tek nje ndermjetes ne rast te nje administrimi te keq ne vendin e institucioneve dhe organeve komunitare



- Pjesa me e gjate e titullit te trete parashikon realizimin ne tre faza te Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, cakton sektore te rinj te veprimit te Komuniteteve (kulture, shendetesi) dhe se fundi sakteson atributet e instritucioneve te ndryshme Komunitare



- **Titulli i III dhe IV** tregojne respektivisht ndryshimet ne kuadrin e krijimit te Bashkimit qe duhen bere ne traktatet e KEQC dhe Euroatom
- **Titulli i V** parashikon nene per politiken e jashtme dhe sigurine e perbashket.
- **Titulli i VI** pershkruan nje numer objektivash per bashkepunimin ne sektoret e drejtesise dhe te puneve te brendshme
- **Titulli i VII** parashikon nene finale dhe permban nje klauzole rishikimi te ketij traktati dhe nje klauzole anetaresimi te vendeve te reja (pra zgjerimi)



- Ekspertet dhe opinionistet perqendrohen te krijimi i Bashkimit Evropian dhe Monetar (BEM) qe do te sjelle nje monedhe te perbashket unike dhe nje banke qendrore unike qe duhet te realizohet, sipas vendimeve te Keshillit Evropian te Madridit ne 1989

Bashkimi monetar do te realizohet ne 3 faza:



- Faza e pare- fillon ne 1 korrik 1990 me lirine e plote te qarkullimit te kapitaleve ne pjesen me te madhe te shteteve anetare (ne kete faze do te krijohet liberalizimi i plote i levizjes se personave te mallrave dhe te kapitalit te parashikuar ne Aktin Unik Evropian per ne 1 janar 1993)



“Schengen”:

▶ jo me kontrolle doganore dhe policie mes shteteve te BE

▶ u forcuan kontrollet jashte kufijve te BE

U rrit bashkepunimi mes policive te shteteve te BE

- **Pakti Schengen eliminon kufinjte**

Franca, Gjermania, Portugalia, Spanja dhe shtetet e Beneluksit janë vendet e para që heqin kontrollet kufitare, përveçse në kufinjte e jashtëm të BE-së, pasuar më vonë nga Austria, Italia, Danimarka, Finlanda, Suedia dhe Greqia, por jo Irlanda apo Irlanda.

- Austria, Finlanda dhe Suedia u futën në BE në fillim të vitit 1995 duke e çuar në 15 numrin e vendeve anëtare.

- Norvegjia do të ishte anëtarësuar nëse votuesit nuk do ta kishin kundërshtuar këtë hap në një referendum të dytë.





- **Traktati I Maastricht shenon fillimin e**
- **fazes se dyte ne 1 janar 1994 gjate te ciles do te ngrihet nje *Institucion Monetar Evropian (IME)* I drejtuar nga nje Keshill I perbere nga nje president dhe guvernatoret e bankave qendrore.**



- Ky institut duhet te pregatise fazen e trete te Bashkimit duke I ngushtuar kufijte e lekundjes se monedhave dhe duke I harmonizuar perqindjet e interesave te monedhave qe te realizoje konvergjencen e ekonomive (pra nje evitim I diference te hapur mes ekonomive te ndryshme).
- PARAMETRAT E MASTRITIT
- DEBITI/ PIL JO ME SHUME SE 60%
- DEFICITI/PIL JO ME SHUME SE 3%
- INFLAZIONI JO ME SHUME SE 2%



- **Brenda 31 dhjetorit 1996 kryetaret e shteteve anetare dhe te qeverive do te vendosin me shumice te cilesuar per adoptimin e nje *monedhe unike* dhe nese eshte e pershtatshme qe Komuniteti te kaloje ne fazen e trete te Bashkimit.**



- **Ne rast pozitive do te caktohet data e fillimit nese brenda fundit te 1997 data nuk eshte fiksuar akoma faza e trete do te filloje automatikisht ne 1 janar 1999.**
- **Ne daten e fillimit te fazes se trete Keshilli qe vendos me unanimitetin e shteteve anetare me propozim te Komisionit miraton perqindjen e fiksuar me te cilen ECU (monedhe unike evropiane) shkembetet ne valute dhe shpall ECU ne valute me te drejte te plote.**

10 dhjetor, 1991



- **Traktati i Maastricht-it** e kthen Komunitetin në Bashkim
- Në dhjetor nënshkruhet Traktati i Maastricht-it për Bashkimin Evropian.
- Ai hap rrugën për bashkimin monetar dhe përfshin një kapitull për politikën sociale.
- Britania negocion që të qëndrojë jashtë të dyjave.
- Traktati fut gjithashtu elementin e shtetësisë evropiane duke u dhënë evropianëve të drejtën për të jetuar dhe votuar në zgjedhje në cilindo vend të BE-së si dhe përbën fillesën e bashkëpunimit evropian në çështjet e jashtme, sigurisë, strehimit politik dhe imigracionit.



Fund




Leksion 10

Institucionet e BE

**Tema: Parlamenti European,
Këshilli i Bashkimit European
dhe Këshilli European**

Grafiku : BE sot






Disa nga karakteristikat kryesore te sistemit institucional te BE-se jane:




- 1-Struktura institucionale si nje strukture disapaleshe. Struktura institucionale e Bashkimit evropian nuk e prodhon ne menyre te perkryer skemen klasike te trasheguar nga Montesquieu, i cili dallon pushtetin **ekzekutiv**, **legjislativ** dhe **gjyqesor**.

>>> *Ne menyre te pergjithshme:*



- **pushteti gjyqesor**  *i takon Gjykates se Drejtesise,*
- **pushteti legjislativ**  *ndahet ndermjet Keshillit dhe ne nje pjese me te vogel me Parlamentit,*
- **pushteti ekzekutiv**  *i takon Komisionit dhe Keshillit*
- (- kur Komisioni asistohet ne punen e tij edhe nga nje komitet i specializuar i fushes dhe vendimi del me i pjekur).



Strukture institucionale disapaleshe.

Parlamenti evropian



- --zgjidhet me votim te pergjithshem te popujve, por ai ka pushtet te kufizuar.
- Thelbi i pushtetit legjislativ eshte perqendruar ne duar e Keshillit i cili mbledh ministrat e vendeve anetare te BE-se te cilet jane pergjegjes perpara parlamenteve te vendeve te tyre, parlamente keto te zgjedhura nga popujt respektive.

- Ne fund Komisioni emerohet nga qeverite e vendeve pjesetare, por ai eshte gjithmone nen tutelën e Parlamentit.
- *Pra ruajtja e nje ekuilibri ndermjet **Keshillit, Komisionit, dhe Parlamentit** eshte baza e funksionimit te demokracise institucionale te BE-se.*
- Elementet kryesore te kontrollit demokratik jane prezente ne kete sistem institucional por efikasiteti i tyre eshte akoma e paplote.

Parlamentit Evropian (PE)



- kemi të bëjmë me organin e parë në nivel mbikombëtar, i cili në dallim nga [Këshilli](#) ose [Komisioni](#) mbart një cilësim të njohur tashmë nga sistemet politike kombëtare.
- Ai është organi i vetëm në nivel mbikombëtar, që zgjidhet drejt për së drejti.
- Kompetencat dhe roli i PE në Komunitet kanë qenë që prej themelimit të KEQÇ në ndryshim të vazhdueshëm, dhe pikërisht në një shndërrim të tillë, nga i cili ai përfitoi një ndikim në rritje.



- Etapa të rëndësishme këtu kanë qenë zgjerimi i kompetencave të tij në çështje të buxhetit (1975), realizimi i zgjedhjeve të para të drejtpërdrejta (1979),
- futja e procedurës së bashkëpunimit (1986)
- dhe e asaj të bashkëvendosjes (1992) si dhe së fundmi, me anë të ndryshimeve vijuese të traktatit, një zgjerim i konsiderueshëm i fushave, ku gjen zbatim procedurë bashkëvendosjeje.



- me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës PE merr më shumë kompetenca, në të drejtën buxhetore të të cilit është përfshirë tanimë edhe sektori bujqësor, të cilit në vitin 2009 iu caktua jo më pak se 42% e shpenzimeve (rreth 43 mrd. euro €).

PE





Traktati i Lisbonës vendosi rritjen e numrit të deputetëve nga 736 në 750 plus *Kryetarin e Parlamentit.*

- ***Socialdemokrati Martin Schulz*** - kryetar i ri i Parlamentit Evropian
- 56 vjeçari Martin Schulz u zgjodh si pasardhës i konservatorit nga Polonia Jerzy Buzek dhe do të jetë në këtë post dy vjet e gjysmë.





- Gjatë një takimi të Këshillit Evropian në qershor 2010 ky numër u rrit edhe me tre deputetë të tjerë, pra 754; gjithsesi mbetet e paqartë, se kur duhet të nisin nga puna këta deputetë shtesë.
- Një dallim i qartë me parlamentet kombëtare qëndron në faktin se PE përbëhet nga fraksione ndërshtetërore, si për shembull nga Partitë Evropiane Popullore apo Fraksioni i Partive Socialiste dhe Socialdemokrate.

Parlamenti Evropian



- Parlamenti evropian perbehet nga anetaret e shteteve (jo qeverive) anetare te BE-se, te zgjedhur keto drejtperdrejte nga popuj respektive te shteteve anetare te BE-se.
- Pra, parlamentare evropiane perfaqesojne *"popujt e shteteve te bashkuar ne Bashkimin evropian"*.
- Ato nuk jane perfaqesues te qeverive prandaj si rregull, votojne pa asnje "udhezim" ose "shtrengim" qeveritar.



- **Ne Parlamentin Evropian dy jane grupet me te rendesishme partiake:**
- **Partia Popullore Evropiane (me nje dominace te kristian-demokrateve evropiane) dhe Partia Socialiste Evropiane.**
- *Numri i popullsise se nje shteti anetar eshte nje element i rendesishem i mases se perfaqesimit te atij shteti ne Parlamentit Evropian.*

Number of seats per country (2009 – 2014 parliamentary term)



- *Austria*17;
- *Spain* 50;
- *Belgium*22;
- *Lithuania*12;
- *Bulgaria*17
- *Luxembourg* 6;
- *Cyprus* 6;
- *Malta* 5;
- *Czech* 22
- *Netherlands* 25
- *Denmark*13;
- *Poland* 50;
- *Estonia*6;
- *Portugal* 22;
- *France*72;
- *Finland*13
- *Romani* 33
- *Slovakia* 13;
- *Germany* 99;
- *Slovenia*7
- *Greece* 22;
- *Latvia*8;
- *Hungary* 22;
- *Sweden*18;
- *Ireland*12;
- *United Kingdom*72;
- *Italy*72;

Zgjedhja e Parlamentit evropian. Anetaret e Parlamentit




P.Evropian zgjidhen per nje kohezgjatje prej **5 vitesh** (neni 19, paragrafi 3 i TKE, ish neni 138),

ne **zgjedhje te drejtperdrejta** sipas nje procedure te njejte qe aplikohet ne te gjithë shtetet anetare te Parlamentit (neni 190 paragrafi 4 TKE ish neni 138).

.



- Deri ne vitin 1979, anetaret e Parlamentit Evropian caktoheshin nga anetaret e parlamenteve te tyre kombetare.
- Nga 1979 procedura e zgjedhjeve u shnderrua ne zgjedhje te drejtperdrejta cdo 5 vjet.
- ***Selia, vendet e punes dhe organizimi i punes:***



"Vendet e punes" se Parlamentit Evropian levizin ndermjet Frances, Belgjikes dhe Luksemburgut.

Puna e Parlamentit evropian zhvillohet

me:



- **sesione plenare**, ku te gjithë deputetet mblidhen ne Strasburg, qytet ky qe perben edhe seline e Parlamentit evropian.
- **komisionet parlamentare**, te cilet ashtu si dhe sesionet plenare perbehen nga deputetet te grupuar ne keto komisione, te cilat ndodhen ne Bruksel.
- **sekretariati i pergjithshem**, i cili eshte i vendosur ne Luksemburg.

Parlamenti Evropian

8 fraksione mbikombëtare:

- Partia Popullore Evropiane (Kristiandemokratët)
- Socialistët dhe socialdemokratët
- Liberalët dhe Demokratët për Evropën
- Aleanca e të gjelbrës / e lirë evropiane
- Konservativët dhe reformistët
- E majta e bashkuar evropiane/ E majta e gjelbërt nordike
- „Evropa e lirisë dhe demokracisë“
- Pa fraksion

Kryesia

Zgjedhje për 2,5 vjet

Plenum: 736 deputetë
Prej vitit 1979 ndikim në rritje

Zgjedhje për 5 vjet

Qytetarët Unionit

Detyrat

Ligjvënie,
Kontroll i buxhetit
Funksione mbikqyrëse



24 komisione

Stadi: Legjislatura e 7-të, 2009-2014

Funksionet kryesore te Parlamentit Evropian (nenet 192- 195 TKE).



□ *Parlamenti evropian ka tre funksione thelbësore:*

- Parlamenti Evropian ndan me Keshillin *funksionin legjislativ* qe nenkupton miratimin e ligjeve evropiane (direktivat, rregullat dhe vendimet).
- Pjesemarrja e Parlamentit, kontribuon ne garantimin e demokracise lidhur me tekstet e adoptuara (demos-cratia, dhe parlamenti si nje prodhim i popullit)



- Parlamenti evropian ndan me Keshillin funksionin *buxhetor*, pra gjykon e percakton shpenzimet komunitare .
- Ne fund, Parlamenti ka kompetencen te adoptoje buxhetin komunitar ne teresine e tij.
- Parlamenti *ushtron "kontroll demokratik" mbi Komisionin Evropian*. Ai voton kandidatet per anetare te Komisionit dhe gjithashtu ka edhe pushtetin e kontrollit mbi to.
- Ne pergjithesi Parlamenti Evropian ka kompetencen e ushtrimit te kontrollit politik mbi te gjithe institucionet e BE-se, por vecanerisht mbi Komisionin Evropian.

Le t'i shikojme me ne hollesi funksionet e Parlamentit evropian



Funksioni Legjislativ i Parlamentit (Nenet 191 dhe 251 te TKE).

Parlamenti bashkepunon me Keshillin ne ndertimin dhe ne miratimin e teksteve legjislative te propozuara keto nga Komisioni.

- ✚ Menyra me e perdorshme legjislative eshte ***bashkevendosja***, e cila i vendos si Parlamentin dhe Keshillin ne nje nivel te barabartesh,
- ✚ Kjo si menyre legjislative eshte perdorur ne aktet normative qe mbulonin ceshtjet e levizjes se lire te punonjesve, te vendosjes se tregut te perbashket, te mbrojtjes se mjedisit, etj.



- Si perfundim, ne fushen legjislative te BE-se, ne qofte se Komisioni eshte burimi kryesor i BE-se ne fushen e iniciatives legjislative, Parlamenti luan nje rol shtytesi te rendesishem politik.

Funksioni Buxhetor i Parlamentit (nenet 272 i TKE).



- Parlamenti dhe Keshilli jane organizmat kyc te miratimit te buxhetit vjetor komunitar.
- **Cdo vit komisioni pergatit nje projekt-buxhet dhe ia paraqet kete per aprovim Keshillit.**
- Pastaj Komisioni dhe Keshilli negociojne me Parlamentin per ndonje ze te buxhetit dhe per nje levrime sa me te lehte te fondit.
- Miratimi final i buxhetit vjen nga Parlamenti dhe buxheti hyn ne fuqi duke u nenshkruar perfundimisht nga Presidenti i Parlamentit Evropian.

Funksioni i "Kontrollit demokratik" nga ana e Parlamentit (nenet 197/3, 279, 201 TKE).



- Parlamenti ushtron kontrollin demokratik mbi Komisionin, mbi zgjedhjen e presidentit dhe te anetareve te tij, duke i votebesuar.
- Gjithashtu, Komisioni eshte pergjegjes politikisht perpara Parlamentit, pasi ky i fundit mund te votoje kunder Komisionit nje mocion mosbesimi, duke kerkuar keshtu edhe doreheqjen.



- Ne menyre me te pergjithshme, kontrolli parlamentar ushtrohet nepermjet degjimit te raporteve qe Komisioni paraqet perpara Parlamentit me kerkesen e ketij te fundit (raporti perfundimtar, ai mbi perdorimin e buxhetit, ai i aplikimit te se drejtes komunitare, etj).

Puna e Parlamentit evropian organizohet ne dy etapa te medha:



- **pergatitja per sesionin plenar nga deputete te grupuar ne *komisione parlamentare te specializuara*, sipas fushave te ndryshme te veprimtarise se Bashkimit evropian.**
- ***sesioni plenar*, i cili mbledh te gjithe deputetet me qellim ekzaminimin konkret te nje propozimi.**
- **Sesionet plenare zhvillohen normalisht ne Strasburg (nje jave ne muaj) dhe ndonjehere edhe ne Bruksel (dy dite).**



- ✚ **Format me te njohura se si operon ne vendosje PE jane:**
- ✚ ***Procedura e mendimit te njehsuar (1 'avis conforme), e krijuar nga Akti Unik Evropian, konsiston ne ate qe Keshilli duhet te marre edhe pelqimin e Parlamentit evropian qe disa vendime te rendesise se madhe te merren.***
- ✚ **Parlamenti Evropian mund ta pranoje ose ta rrezoje nje propozim, pa e permiresuar ate.**
- ✚ **Pas traktatit te Amsterdamit nje forme e tille perdoret per raste te shkeljes se rende dhe te vazhdueshme te te drejtave themelore te njeriut nga nje shtet anetar.**

>>> *Procedura e mendimit te thjeshte* (1 'avis simple).



- *Kjo procedure parashikon qe Keshilli perpara se te marre nje vendim, duhet te keshillohet paraprakisht me Parlamentin evropian dhe duhet ta marre parasysht mendimet e tij.*
- *Kjo procedure perdoret me shume ne fushen e politikës bujqesore te BE-se.*



- Procedura, e cila në versionet e mëparshme të traktateve ishte cilësuar si procedurë bashkëvendosjeje, zbatohet pothuaj në të gjitha rastet, kur Këshilli vendos me shumicë të cilësuar.
- Ajo karakterizohet nga fakti, që këtu Parlamenti Evropian (PE) zë një pozicion të barabartë me Këshillin, pasi pa miratimin e PE nuk mund të hyjë në fuqi asnjë akt ligjor.
- Atëherë, le të vimë në rrjedhën e kësaj procedure vërtet komplekse, e cila rregullohet **me nenin 294 të Marrëveshjes për Mënyrën e Funkcionimit të BE.**
- Sikurse shihet në figurën e mëposhtme, kjo procedurë mund të përfshijë deri tre seanca dëgjimi.



Në fillim është propozimi i Komisionit.

- Lidhur me këtë propozim PE paraqet këndvështrimin e vet në një seancë të parë dëgjimi dhe ia përcjell atë Këshillit. Nëse ky i fundit e miraton pozicionimin e PE, atëherë akti ligjor në fjalë zyrtarizohet sipas këndvështrimit të PE. Dhe ky është varianti më i thjeshtë.
- Nëse Këshilli nuk e jep miratimin e vet për gjykimin e PE, atëherë ai përcakton një pozicion të vetin lidhur me këtë në seancën e parë të dëgjimit dhe ia përcjell atë PE duke e njoftuar këtë të fundit hollësisht lidhur me arsyet. Po kështu, Komisioni informon në mënyrë të plotë PE rreth gjykimit të vet, dhe pas kësaj vijon një seancë e dytë dëgjimi.
- Këtu PE ka në dispozicion tre opsione të hapura:



- **(1) Nëse PE e miraton vlerësimin e Këshillit brenda tre muajsh pas marrjes së tij ose nëse ai nuk shprehet rreth tij, atëherë akti ligjor në fjalë bëhet i vlefshëm në versionin e formulimit të Këshillit.**
- **(2) Nëse PE e hedh poshtë vlerësimin e Këshillit me shumicën e anëtarëve të tij, atëherë akti ligjor në fjalë nuk quhet i vlefshëm.**
- **(3) Nëse PE propozon me shumicën e anëtarëve të vet ndryshime në vlerësimin e Këshillit, atëherë versioni i ndryshuar kësisoj i përcillet Këshillit dhe Komisionit; komisioni jep gjykimin e tij lidhur me ndryshimet.**



Nëse Këshilli miraton me shumicë të cilësuar të gjitha këto ndryshime të PE jo më vonë se **tre muaj** pas marrjes së tyre, atëherë akti ligjor në fjalë bëhet i vlefshëm. Nëse nuk miratohen të gjitha ndryshimet, atëherë Kryetari i Këshillit, në koordinim me Kryetarin e PE, thërret brenda gjashtë javësh Komisionin Ndërmjetës.


- Ky komision përbëhet nga 27 përfaqësues të vendeve anëtare si dhe nga 27 përfaqësues të PE, të cilët emërohen nga fraksionet përkatëse si dhe nga radhët e anëtarëve të Komisionit të Buxhetit apo komisionesh të tjera, të cilët preken nga objekti i aktit ligjor në fjalë. Delegacioni i PE drejtohet nga Kryetari, detyrë që ky i fundit mund t'ia kalojë edhe një zv.Kryetari me përvojë në çështje të buxhetit ose kryesisë së Komisionit të Buxhetit.
- Nëse Komisioni Ndërmjetës nuk arrin të miratojë një tekst të përbashkët brenda gjashtë javësh pas thirrjes së tij, atëherë akti ligjor i propozuar nuk konsiderohet i vlefshëm.



Nëse Komisioni Ndërmjetës arrin të miratojë brenda këtij afati një tekst të përbashkët, dhe nëse ky i fundit miratohet prej PE me shumicën e votave të dhëna brenda një afati gjashtëjavor dhe në Këshill me shumicë të cilësuar atëherë akti ligjor në fjalë konsiderohet i vlefshëm;

nëse jo, atëherë nuk konsiderohet i vlefshëm.

Procedura e rregullt ligjvënëse në BE





- **Për kujtesë: Cili është roli i Parlamentit Evropian në lidhje me zgjerimin?**
- **Neni 49** (Ex-Artikel O) Marrëveshja mbi BE – pranimi i shteteve të tjera anëtare. "*Çdo shtet evropian [...] mund të bëjë kërkesën për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Kërkesa i dorëzohet Këshillit i cili duhet të vendosë njëzëri pasi ka dëgjuar Komisionin dhe ka marrë miratimin e Parlamentit Evropian, i cili merr vendimin e vet me shumicë absolute (shënim i autorit: të paktën 50% +1 të të gjithë deputetëve).*"
- **Udhëzim:** Për arsye teknike të lojës simulohet vetëm një seancë e Komisionit për Punët e Jashtme!

Këshilli i Bashkimit Evropian



- Eshtë institucioni që përcakton politikat e përgjithshme dhe prioritetet e BE.
- KBE nënkupton takimet e rregullta të krerëve të shteteve ose qeverisë së Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, Presidentit të KBE dhe Presidentit të Komisionit Evropian.
- Ekzistenca e Këshillit Evropian u njoh ligjërisht në Aktin Unik Evropian, ndërsa statusi zyrtar iu dha në Traktatin e Bashkimit Evropian. Këshilli Evropian mbledhet të paktën dy herë në vit dhe Presidenti i Komisionit Evropian merr pjesë si anëtar me të drejta të plota.
- Qëllimet e tij janë t'i japë Bashkimit Evropian nxitjen që duhet për të zhvilluar më tej dhe për të përcaktuar udhëzimet e përgjithshme të politikës.

Presidenti i Këshillit European -Charles Michel



- **Krijimi 1961 (jo zyrtarisht), 2009 (zyrtarisht)**
- **Institucion i BE**
- **Zyrat qendrore-Bruksel**
- **Website-consilium.europa.eu**



- Këshilli Evropian është institucioni kryesor vendimmarrës i Bashkimit.
- Përbëhet nga ministrat e 27 Shteteve Anëtare.
- Çdo Shtet Anëtar mban drejtimin e Këshillit për një periudhë 6 mujore. Secili prej ministrave në Këshill ka plotfuqishmëri.
- Kjo do të thotë se, deklarimet dhe veprimet e tij janë plotësisht të afta për të angazhuar qeverinë që ai përfaqëson. Anëtarët e Këshillit janë përgjegjës ndaj parlamenteve të vendeve të tyre si dhe ndaj qytetareve që këta përfaqësojnë, duke siguruar kështu legjitimitetin e vendimeve të Këshillit.

Këshilli ushtron këto funksione themelore:



- ✚ Miraton normat komunitare në bashkëpunim me Parlamentin Evropian.
- ✚ Koordinon politikat e përgjithshme ekonomike të shteteve anëtare.
- ✚ Lidh marrëveshje ndërkombëtare, në emër të Bashkimit Evropian, me shtete ose organizata ndërkombëtare.
- ✚ Aprovon buxhetin e Bashkimit së bashku me Parlamentin Evropian.
- ✚ Zhvillon Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, në baze të direktivave të Këshillit Evropian.
- ✚ Koordinon bashkëpunimin midis gjykatave dhe forcave policore të shteteve anëtare në çështjet penale.



- **Keshilli i Bashkimit Evropian (ndryshe Keshilli i ministrave ose thjesht Keshilli) eshte organi kryesor vendimmarres i Bashkimit Evropian.**
- **Ai mbledh ministrat e Shteteve anetare te asaj fushe qe eshte shtruar per t'u diskutuar ne rend te dites.**
- **Shtetet anetare mblidhen rregullisht, ne nivel ministror.**

Këshilli i Bashkimit Evropian (Këshilli i Ministrave)

Gjithnjë e më shumë vendime me shumicë të cilësuar

Përbëhet nga ministrat e shteteve anëtare, në rotacion sipas sektorit

Organ qendror vendimmarrës ligjvënës

Presidenca e Këshillit

Ndërron çdo gjashtë muaj

Komisioni i Përfaqësuesve të Përhershëm

Përgatit punën e Këshillit



300 komisione dhe grupe pune

Sekretaria e Përgjithshme

Mbështet punën e Këshillit



3.500 bashkëpunëtorë



- Sipas ceshtjeve te rendit te dites, Keshilli mbledh ne fornacione te ndryshme: ceshtjet e puneve te jashtme, te finances, te arsimit, telekomunikacionit, etj.
- Keshilli permbledh shume funksione, nga te cilat do te permendim:
 - Ai eshte organi legjislativ i Bashkimit Evropian.
 - Keshilli e ushtron kete pushtet legjislativ ne bashkevendosje me Parlamentin evropian.

Procedura e bashkepunimit (la cooperation)



- U perfshi ne veprimtarine e Parlamentit evropian me Aktin Unik evropian.
- Kjo procedure i jep Parlamentit evropian nje mundesi te madhe per te influencuar progresin legjislativ nepermjet nje *"leximi te dyte"* te propozimeve legjislative te Komisionit.
- Fusha e aplikimit te procedures se bashkepunimit ka qene reduktuar nga traktati i Amsterdamit per llogari te procedures se bashkevendesjes dhe permban aspekte te caktuara te lidhur me Bashkimin ekonomik dhe monetar.

Procedura e bashkevendosjes (Ia codecision).



- **Kjo procedure u soll nga traktati i Maastricht-it (neni 2511 ish neni 189 B te traktatit KE).**
- **Kjo procedure i jep tagrin Parlamentit evropian per te ndaluar akte nornative, se bashku me Keshillin.**
- **Kjo praktike zbatohet ne fushat, si qarkullimi i lire i punetoreve, e drejta e vendqendrimit, qarkullimi i lire i sherbimeve, shkollimi, etj.**



- **Ai siguron bashkepunimin e politikave ekonomike te pergjithshme te Shteteve anetare.**
- **Ai permbush ne emer te Komunitetit, traktatet nderkombetare ndermjet Bashkimit dhe nje ose me shume Shteteve organizatave nderkombetare.**
- **Ai ndan pushtetin buxhetor me Parlamentin.**



- **Ai merr vendime te domosdoshme ne percaktimin dhe ne venien ne jete te politikës se jashtme dhe te sigurise se perbashket.**
- **Ai siguron, bashkepunimin e veprimtarise se Shteteve anetare dhe miraton masat ne fushen e bashkepunimit policor dhe juridik ne fushen penale, etj.**



- Cdo vend i caktuar i Bashkimit evropian ushtron *presidencen e Bashkimit evropian*, me rotacion, per nje kohezgjatje 6 mujore.
- Vendimet e Keshillit pergatiten nga nje *komitet perfaqesuesish permanent te Shteteve anetare (COREPER)*, i asistuar ky edhe nga nje grup I perbere nga funksionare te administratave te shteteve anetare.

Keshilli perbehet nga nje Sekretariat i pergjithshem.



- **Ne kuadrin e shtylles se pare, vendimet e Keshilli merren ne baze te propozimeve te Komisionit.**
- **Keshilli siguron prezantimin e Shteteve anetare ne nivel te Bashkimit evropian dhe ai atje perben shkallen kryesore te vendimmarrjes.**
- **Perfaqesuesit e qeverive qe bejne pjese ne Keshill jane politikisht pergjegjes perpara parlamenteve te tyre ashtu si dhe perpara qytetareve qe ato perfaqesojne.**

Selia dhe perberja e Keshillit.



- **Selia e Keshillit eshte ne Bruksel.**
- Aty marrin jete edhe "*sesionet ministrore*" pra takimet ndermjet ministrave.
- Ne Bruksel zhvillohen te gjitha takimet ministrore ne te gjithë muajt e vitit, pervec takimeve te muajve prill, qershor dhe tetor, muaj keto ku sesionet ministrore zhvillohen ne Luksemburg.

- **Keshilli formohet nga perfaqesuesit e shteteve anetare (nje perfaqesues per cdo shtet anetar) ne nivel ministror, cilesi kjo qe i jep aftesine atij (ministrit pjesernarres ne takim) te angazhoje qeverine e tij.**



- **Ne fakt ekziston vetem nje Keshill i vetem, i cili mblidhet ne formacione te ndryshme, sipas temes se rendit te dites.**

Formacionet me te perdorshme jane si me poshte:

- ceshtje te pergjithshme si bujqesi, ceshtje te ekonomise dhe te finances, mjedis, trasport-telekomunikacion, punesim dhe politike sociale, peshkim.

Funksionet e Keshillit, Keshilli i Bashkimit evropian ushtron tre funksione kryesore:



- **1) ai ushtron pushtet ne vendimmarrje.**
- **2) ai siguron koordinimin e politikave ekonomike te Shteteve anetare.**
- **3) ai ndan pushtetin buxhetor me Parlamentin evropian.**

- **Pushteti ne vendimmarrje. Pushteti vendirnmarres i Keshillit ushtrohet per te siguruar realizimin e objektivave te percaktuar nga traktatet.**
- **Keshilli vepron vetem, ne baze te propozimeve te Komisionit Evropian dhe ne shumicen e rasteve me pjesemarrjen e Parlamentit evropian (raste keto qe permbledhin procedurat tashme te shpjeguara te bashkevendosjes, mendimit te thjeshte (konsultimit) dhe ate te mendimit te njehsuar).**



- Ne ceshtjet qe lidhen me elemente thelbesore te sovranitetit te shtetit, Keshilli luan nje rol kryesor sidomos ne lidhje me ceshtje te formatit te *politikes se jashtme dhe te sigurise se perbashket* (shtylla e dyte) dhe *bashkepunimit policor ne fushen penale* (shtylla e trete), fusha keto ku rolet e Komisionit dhe Parlamentit jane shume te dobet.

Koordinimi i politikave ekonomike te Shteteve anetare.



- **Traktati i Bashkimit Evropian (i konsoliduar) parashikon ndertimin e nje politike ekonomike te bazuar ne bashkeveprimin (koordinimin) e ngushte midis politikave ekonomike te vete Shteteve anetare.**
- **Me kete qellim, *Keshilli miraton cdo vit nje projekt orientimesh te medha te politikave ekonomike te Shteteve anetare.***
- **Ne vazhdim ky projekt transformohet ne formen e rekomandimit te Keshillit dhe kjo sigurohet nga nje mekanizem i shumanshem ruajtjeje.**



Leksion 12

INSTITUCIONET e BE

Komisioni European

Ndërthurje e niveleve në sistemin disaniveles



Organet e BE

Niveli mbikombëtar

Komisioni Evropian

Këshilli i BE

Këshilli Evropian

Parlamenti Evropian

Gjykata e BE

Zyra Evropiane e Revizionit

Ligjvënia

Jurisdiksioni

Banka Qendrore Evropiane

Komisioni Ekonomik dhe Social

Komisioni i Rajoneve

Këshillimi

Të gjitha shtetet anëtare. Struktura të veçanta institucionale. *Aktorët:* Qeveritë kombëtare, parlamentet, partitë, shoqatat, popullsitë

Niveli kombëtar

Njësitë rajonale në disa prej shteteve anëtare. Struktura të veçanta institucionale. *Aktorët:* qeveritë nënkombëtare, administratat, parlamentet, partitë, shoqatat etj.

Niveli nënkombëtar

Komisioni Evropian



- Komisioni është, si në politikën ndërkombëtare ashtu edhe në atë kombëtare, i pari organ vërtetë **mbikombëtar**.
- Ai përbëhet aktualisht nga 27 anëtarë, të cilët propozohen nga qeveritë e shteteve anëtare dhe emërohen me një mandat **pesëvjeçar**, për të cilin ndërkohë nevojitet edhe miratimi i Parlamentit Evropian.





- **Është institucion politikisht i pavarur, i cili i përfaqëson dhe i promovon interesat kolektive të BE-së si tërësi.**
 - **Komisioni është fuqia udhëheqëse e sistemit institucional të BE-së.**
Komisioni kryen katër funksionet në vijim:
- Është iniciator i politikës dhe i legjislacionit të Unionit, e propozon normativën ligjore në Parlament dhe Këshill,*
 - Është trup kryesor ekzekutues i cili e zbaton legjislacionin e UE-së, nëpërmjet marrjes së masave dhe vendimeve konkrete për implementimin e tij. Komisioni i zbaton vendimet e Këshillit, udhëheq me realizimin e buxhetit dhe i zbaton politikat e BE-së,*



- ❑ Komisioni është “rojë e marrëveshjeve”, doemos duhet të sigurojë se vendet anëtare i zbatojnë **normativat** dhe **direktivat** të cilat i miratojnë Këshilli dhe Parlamenti.
- ❑ Komisioni së bashku me Gjykatën e drejtësisë, është përgjegjëse që ligji i UE-së të zbatohet në mënyrë të drejtë, në të gjitha vendet anëtare
- ❑ përfaqëson UE-në në skenën ndërkombëtare, është negociator i rëndësishëm në emër të UE-së për marrëveshjet dhe kontaktet ndërkombëtare, me vendet e treta dhe me organizatat ndërkombëtare.



Komisarët nuk duhet të veprojnë për llogari të vendit të tyre të origjinës, por duhet të angazhohen në pavarësi të plotë për interesin e Komunitetit.

Ata mbështeten nga plot 23.000 nëpunës - organizuar në të ashtuquajtura Drejtori të përgjithshme, të cilat mund të ndahen në katër grupe të mëdha:

- ✚ **sektorët politikë** (bujqësia dhe zhvillimi rural, politika e konkurrencës, politika industriale etj.)
- ✚ **marrëdhëniet me jashtë** (zhvillimi, zgjerimi, tregtia etj.)
- ✚ **shërbimet e përgjithshme** (Eurostat, Sekretaria e Përgjithshme etj.)
- ✚ **shërbimet e brendshme** (buxheti, përkthimet etj.)

Komisioni Evropian

Propozime
për zhvillimin e
mëtejshëm të politikës së
BE

27 anëtarë:
një Komisar për
çdo vend anëtar

**Përfaqësim së
jashtmi**
p.sh. në organizata
ndërkombëtare

**Drejtoria e
Përgjithshme**

Sektorët e
politikës (22)

Marrëdhëniet e
jashtme (4)

Shërbime të
përgjithshme (8)

Shërbime të
brendshme (11)

Kontrolli
i respektimit dhe zbatimit
të marrëveshjeve

**Detyrat e
Komisionit**

Ekzekutivi
Zbatimi i politikës së
Unionit

Detyrat qendrore të Komisionit mund të përshkruhen me katër fjalë kyçe:



- ***E drejta për iniciativë:*** Çdo vendim i Këshillit duhet të paraprihet nga një propozim i Komisionit. Ai, si një motor i integritit, duhet të përpunojë propozime për zhvillimin e politikës komunitare. E drejta për të përcaktuar rendin e ditës, për të bërë propozime në një moment të caktuar si dhe për të lidhur iniciativat me njëra-tjetrën, i lejon Komisionit të ushtrojë një ndikim të konsiderueshëm në procedurat ligjvënëse.
- ***Mbrojtës i marrëveshjeve:*** Komisioni mbikqyr zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve dhe të vendimeve të marra nga organet e Komunitetit Evropian dhe, në rast se konstaton shkelje të tyre, mund të kërkojë ndërmjetësinë e Gjykatës Evropiane.

Detyrat qendrore të Komisionit mund të përshkruhen me katër fjalë kyçe:



- ***Përfaqësim i jashtëm:*** Komisioni duhet të përfaqësojë Komunitetin për shembull në seancat e GATT/WTO dhe përballë Organizatave Ndërkombëtare; kjo realizohet pjesërisht së bashku me shtetet anëtare dhe/ose me Presidencën e radhës.
- ***Organ ekzekutiv për zbatimin e politikës komunitare:*** këtu përfshihet administrimi i financave publike si dhe zbatimi i politikave. Kjo, natyrisht, nuk do të thotë, që vetë Komisioni do të marrë përsipër zbatimin konkret në shtetet anëtare të urdhëresave dhe direktivave të panumërta.
Ndërsa detyra kryesore e Komisionit qëndron në mbikqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të këtyre rregullave nga shtetet anëtare.



KURSI VEROR
04-08 KORRIK, 2022

Multilinguizmi në Bashkimin European



Funded by
the European Union

DR. MANJOLA ZAÇELLARI


Shumëgjuhësia/Multilinguizmi

- ▶ Sot në mbarë botën fliten rreth 7000 gjuhë.
- ▶ Megjithatë, gjysma e popullsisë së botës ndan vetëm gjashtë gjuhë amtare dhe rreth 90% e të gjitha gjuhëve mund të zëvendësohen nga ato dominuese deri në fund të shekullit.
- ▶ Bashkekzistenca harmonike e 24 gjuhëve zyrtare është një nga tiparet më dalluese të projektit evropian.
- ▶ Shumëgjuhësia nuk është vetëm një shprehje e identiteteve kulturore të vendeve të BE-së, por gjithashtu ndihmon në ruajtjen e demokracisë, transparencës dhe llogaridhënies.

- ▶ Asnjë legjislacion nuk mund të hyjë në fuqi derisa të përkthehet në të gjitha gjuhët zyrtare dhe të publikohet në Fletoren Zyrtare të BE-së.
- ▶ Në mënyrë thelbësore, dispozitat në lidhje me regjimin gjuhësor të BE-së mund të ndryshohen vetëm me votim unanimit në Këshillin e BE-së.
- ▶ BE-ja është e përkushtuar për të promovuar mësimin e gjuhës, por ka ndikim të kufizuar mbi politikat arsimore dhe gjuhësore, pasi këto janë përgjegjësi e vendeve antëtare të BE-së.
- ▶ Në vitin 2016, mbi një e treta (35.4%) e të rriturve në BE nuk dinin asnjë gjuhë të huaj.

Statistika

- ▶ Një përqindje e ngjashme (35.2%) deklaruan se dinin një gjuhë të huaj, ndërsa pak më shumë se një e pesta (21%) thanë se dinin dy gjuhë të huaja.
- ▶ Parlamenti Evropian është i përkushtuar të sigurojë shkallën më të lartë të mundshme të shumëgjuhësisë në punën e tij.
- ▶ Bazuar në 24 gjuhët zyrtare që përbëjnë fytyrën publike të BE-së, numri i përgjithshëm i kombinimeve gjuhësore rritet në 552, pasi secila gjuhë mund të përkthehet në 23 të tjerat.
- ▶ Aktualisht, mbi 600 të punësuar në përkthim dhe mbi 270 në përkthim kujdesen për nevojat e përkthimit të 705 anëtarëve të Parlamentit Evropian.
- ▶ Brenda vendit, institucionet e BE-së përdorin kryesisht vetëm tre gjuhë pune: anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht.

- 
- ▶ Kostoja e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të përkthimit dhe përkthimit në institucionet e BE-së është rreth 1 miliard euro në vit, që përfaqëson më pak se 1% të buxhetit të BE-së ose pak më shumë se 2 euro për qytetar.

Diversiteti gjuhësor në botë

- ▶ Sot në botë fliten nga 6000 deri në 7000 gjuhë. Të japësh një shifër të saktë është e pamundur, pasi kufiri midis një gjuhe dhe një dialekti nuk është i përcaktuar mirë.
- ▶ Çuditërisht, 97% e popullsisë së botës flet rreth 4% të gjuhëve të botës, ndërsa vetëm rreth 3% flasin afërsisht 96% të gjuhëve të mbetura. Gjysma e 7.8 miliardë banorëve të botës ndajnë vetëm gjashtë gjuhë amtare.
- ▶ Rreth 3% e gjuhëve të botës (255) i përkasin Evropës. Numri më i madh i gjuhëve të gjalla – 2,165 – gjendet në Azi.
- ▶ Nëse nuk ndryshojnë tendencat aktuale, rreth 90% e të gjitha gjuhëve që fliten sot mund të zëvendësohen nga ato të tjera dominuese deri në fund të shekullit. Atlasi i UNESCO-s për gjuhët e botës në rrezik zbulon se 40% e gjuhëve të folura në botë janë të rrezikuara.
- ▶ Është shqetësuese, sepse 2000 nga gjuhët e rrezikuara në botë kanë më pak se 1000 folës dhe 4% janë zhdukur në 70 vitet e fundit.

A e dini se...


- ▶ Silbo Gomero, i njohur gjithashtu si el silbo ('fishkëllima'), është një kthim i spanjishtes së folur në fishkëllimë, e përdorur nga banorët e ishullit La Gomera në Kanarie, për të komunikuar nëpër luginat e thella e të ngushta të ishullit. E vetmja gjuhë në botë që është plotësisht e zhvilluar dhe praktikuar nga një komunitet i madh prej më shumë se 22,000 njerëzish, el silbo mundëson shkëmbimin e mesazheve në një distancë deri në 5 kilometra. E mësuar në shkollë që nga viti 1999, Silbo Gomero u regjistrua në Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit të UNESCO-s në vitin 2009.

Drejtimi i një BE-je shumëgjuhëshe


- ▶ Në BE, shumëgjuhësia kuptohet si "aftësia e shoqërive, institucioneve, grupeve dhe individëve për t'u angazhuar, rregullisht, me më shumë se një gjuhë në jetën e tyre të përditshme".

Politika e shumëgjuhësisë e BE-së ka tre qëllime:

- ▶ • të inkurajojë mësimin e gjuhës dhe të promovojë diversitetin gjuhësor. Në të vërtetë, shumëgjuhësia synon të parandalojë diskriminimin midis qytetarëve, gjuhët e të cilëve fliten nga një numër i madh njerëzish dhe të tjerë që përdorin ato më pak të folura;
- ▶ • t'u japë qytetarëve akses në legjislacionin, procedurat dhe informacionin e BE-së në gjuhët e tyre. Shumëgjuhësia u mundëson evropianëve të marrin pjesë në debate dhe konsultime publike;
Profili i politikës arsimore gjuhësore ndryshon nga protokollet e tjera ndërkombëtare për gjuhët në dy mënyra:

- ai i shqyrton gjuhët kryesisht nga këndvështrimi arsimor, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë sistemit arsimor kombëtar.
- ai bazohet në parimin se arsimit gjuhësor duhet të shqyrtohet në mënyrë tërësore dhe jo të copëzuar. Mësimi i gjuhës nuk ka të bëjë vetëm me të ashtëquajturat gjuhë e huaj apo gjuhë e dytë, (në të cilat shpesh kufizohet), por edhe me gjuhën (apo gjuhët) zyrtare/kombëtare, gjuhët e pakicave apo rajonale (duke përfshirë edhe gjuhën e shenjave), gjuhët e emigrantëve të vendosur rishtas, e kështu me radhë.

Procesi i përgatitjes së *Profilit* përfshin gjashtë hapa:

- autoriteti përkatës kombëtar përgatit një Raport Vendor që përshkruan situatën aktuale dhe ngre çështje që janë në diskutim apo rishikim.
- një grup i vogël dhe i përzgjedhur ekspertësh nga Këshilli i Europës nga vendet e tjera anëtare (Grupi i Ekspertëve) viziton vendin për një javë, bashkë me një përfaqësues të Këshillit të Europës me qëllimin që të kuptojë në mënyrë sa më të plotë situatën aktuale dhe mundësitë për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Gjatë vizitës, Grupi i Ekspertëve takon autoritetet kombëtare përkatëse dhe grupe interesi, ku përfshihen specialistë të gjuhëve nga të gjitha nivelet e arsimit, si edhe përfaqësues të shoqërisë civile të përzgjedhur nga autoritetet kombëtare (shoqata të mësuesve apo prindërve, biznesi, media, etj.) Grupi i ekspertëve bën gjithashtu vizita në shkolla dhe universitete.

- Profili i politikës arsimore gjuhësore hartohet nga Raporteri që mbështetet te Raporti Vendor dhe te analizat e Grupit të ekspertëve, duke mbajtur parasysh komentet dhe reagimet e marra gjatë vizitës studimore.
- Projektprofili diskutohet gjatë vizitës së dytë të Raporterit në vend dhe rishikohet sipas rastit.
- Profili miratohet në formën përfundimtare nga Grupi i Ekspertëve dhe autoritetet kombëtare dhe botohet nga Këshilli i Europës¹ në një nga dy gjuhët zyrtare të tij, si edhe nga vendi në fjalë.
- Profili bëhet publik, zakonisht në një eveniment kombëtar në të cilin kontribuojnë edhe ekspertët e Këshillit të Europës.

Kur ofron komentet e tij, Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Europës mban parasysh si prioritetet e vendit në fjalë ashtu edhe politikat dhe pikëpamjet e praktikave të dëshiruara, të parashtruara në dokumentet e Këshillit të Europës, në veçanti ato në lidhje me promovimin e plurilinguizmit dhe arsimit ndërkulturor², si edhe angazhimet e organizatës për cilësi dhe barazi në arsimin gjuhësor si faktor kyç në promovimin e sukseseve arsimore dhe gjithëpërfshirjes.³

1.2 Politika arsimore gjuhësore dhe politika sociale

Objektivi thelbësor i Këshillit të Europës është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit, sikurse u ritheksua në *Deklaratën e Varshavës* në maj 2005. Në këtë kontekst, kushtet kryesore për sukses janë: pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe shoqërisë civile në demokraci dhe qeverisje; promovimi i identitetit dhe bashkimit europian bazuar në vlerat e përbashkëta; si edhe respekti për trashëgiminë e përbashkët dhe diversitetin kulturor. Sikurse thuhet në *Konventën Kulturore Europiane* (1954), studimi i gjuhëve, historisë dhe qytetërimit është i domosdoshëm për të ushqyer mirëkuptimin e ndërsjellë. Nevoja për dialog politik, ndërkulturor dhe ndërfetar e përshkruar në *Kartën e Bardhë për Dialogun Ndërkulturor* të Këshillit të Europës më 2008 mund të përmbushet vetëm duke u mbështetur në një mirëkuptim të tillë.

Mësimnxënia dhe mësimdhënia e gjuhëve janë kështu një pjesë thelbësore e politikës sociale në Europë, prandaj dhe analiza e politikës arsimore gjuhësore është pjesë e përpjekjes që të gjitha

¹ Raporti Vendor dhe Profili janë të disponueshme në internet: www.coe.int/lang

² Shih dokumentet përkatëse të projektit *Gjuhët në arsim, gjuhët për arsim*, të cilat gjenden në [Platform of Resources and References for Plurilingual and Intercultural Education](#). Shih po ashtu udhëzuesit për (i) zhvillimi i politikave arsimore gjuhësore dhe (ii) zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulave për arsimin shumëgjuhësor dhe ndërkulturor, për të cilat do të gjeni më shumë detaje në Shtojcën 2, përkatësisht në paragrafët 5 dhe 7.

³ Shih [Recommendation CM/Rec\(2014\)5](#), për rëndësinë e kompetencës në gjuhën(-ët) e shkollimit për barazi dhe cilësi në arsim, si edhe për suksesin arsimor.

vendet anëtare bëjnë për të përmirësuar politikën sociale. Profili i politikës arsimore gjuhësore është një kontribut në këtë proces.

1.3 Politika arsimore gjuhësore e Këshillit të Europës

Politika arsimore gjuhësore e Këshillit të Europës mbështetet në konceptin themelor të *plurilinguizmit*, që nuk është i njëjtë me *multilinguizmin*:

- *multilinguizmi* ka të bëjë me praninë në një zonë gjeografike, qoftë kjo e vogël apo e madhe, e më shumë se një ‘varianti gjuhësor’, me të cilin nënkuptohet mënyra e të folurës së një grupi social, qoftë ky zyrtarisht i njohur si gjuhë ose jo;
- *plurilinguizmi* ka të bëjë me repertorin e varianteve gjuhësore të përdorura nga individët dhe kështu ai është kundërt i monolingualizmit; ai përfshin variantin gjuhësor të njohur si "gjuha amtare" ose "gjuha e parë" si edhe çfarëdo numri variantesh gjuhësore të çfarëdolloj niveli kompetence.

Në zonat multilinguale ka zakonisht edhe individë monolingualë, por ka edhe të tjerë që janë plurilingualë.

Europa si zonë gjeografike është multilinguale, po ashtu edhe shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Këshilli i Europës ka zhvilluar një konsensus ndërkombëtar për parimet që udhëheqin politikën arsimore gjuhësore. Këto parime promovojnë plurilinguizmin për individin si qëllim qendror për të gjitha politikën arsimore gjuhësore. Ky qëndrim është i formuluar në një numër dokumentesh të listuara në Shtojcën 1.

Kuadri i Përbashkët European i Referencës për Gjuhët e përkufizon plurilinguizmin si vijon: aftësia për të përdorur gjuhët për qëllimet e komunikimit si edhe për të marrë pjesë në bashkëveprime ndërkulturore, ku individë, i parë si aktor social, zotëron në nivele të ndryshme disa gjuhë, si edhe ka përvojë në disa kultura. Kjo nuk duhet të shihet si mbivendosje apo pranëvënie e kompetencave të ndryshme, por si ekzistencë e një kompetence komplekse, madje edhe të përbërë, ku përdoruesi mund të mbështetet.⁴

Kështu, plurilinguizmi lidhet me repertorin e plotë gjuhësor të individit, rrjedhimisht në këtë Profil ne shqyrtojmë të gjithë arsimin gjuhësor në Shqipëri, duke përfshirë arsimimin në gjuhën shqipe, gjuhët rajonale dhe të pakicave, si edhe gjuhët e të huaja.

Ky këndvështrim nuk vendos gjuhët, por folësit e tyre në qendër të politikave gjuhësore. Theksi vendoset te vlerësimi dhe zhvillimi i aftësive të të gjithë individëve për të mësuar dhe përdorur disa gjuhë, për ta zgjeruar këtë kompetencë nëpërmjet mësimdhënies së përshtatshme dhe arsimit plurilingual, qëllimi i të cilit është krijimi i ndjeshmërisë gjuhësore dhe mirëkuptimit kulturor, si

⁴ Këshilli i Europës, *Kuadri i Përbashkët European i Referencës për Gjuhët: Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi*, Cambridge University Press, 2001, f.168. E disponueshme në internet në faqen www.coe.int/lang-CEFR. Shih po ashtu Shtojcën 2.

bazë për qytetari demokratike. Arsimi gjuhësor i shërben në këtë mënyrë të njëjtës axhendë sikurse shprehet në Kuadrin e Referencës për Kulturë Demokratike që Këshilli i Europës ka zhvilluar kohët e fundit.⁵

Ky Profil ndikohet nga qëndrimi i Këshillit të Europës, i përfshirë në Rekomandimet e Komitetit të Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare të Këshilli të Europës⁷ si edhe nga instrumente si *Kuadri i Përbashkët European i Rereferencës për Gjuhët*, dhe i parashtruar hollësisht në *Udhëzuesin për Politikën Arsimore Gjuhësore në Europë*.⁶ Ky dokument i fundit e bën të qartë se plurilinguizmi është gjithashtu një aspekt themelor i politikave të përfshirjes sociale dhe arsimit për qytetari demokratike:

Duke e bërë arsimin për qytetari demokratike një prioritet të Këshillit të Europës dhe shteteve anëtare të tij më 1997, Kërret e Shteteve dhe Qeverive përcaktuan rolin qendror për gjuhët në ushtrimin e qytetarisë demokratike në Europë: në demokraci, nevoja për qytetarë që marrin pjesë aktive në vendim-marrjet politike dhe jetën shoqërore presupozon që kjo pjesëmarrje nuk duhet të bëhet e pamundur nga mungesa e aftësive gjuhësore të duhura. Mundësia për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike në Europë, dhe jo vetën në atë të vendit të individit, lidhet me aftësitë plurilinguale, ose me fjalë të tjera, me aftësinë për të bashkëvepruar në mënyrë efektive me qytetarët e tjerë të Europës.

Zhvillimi i plurilinguizmit nuk është thjesht dhe vetëm një nevojë funksionale: ai është gjithashtu edhe një komponent thelbësor për sjelljen demokratike. Pranimi i repertoreve plurilinguale të diversitetit të folësve duhet të çojë drejt tolerancës gjuhësore dhe kësaj edhe drejt respektit për dallimet gjuhësore: respekti për të drejtat gjuhësore të individëve dhe grupeve në raport me shtetin dhe shumicën gjuhësore, respekt për lirinë e shprehjes, respekt për pakicat gjuhësore, respekt për gjuhët kombëtare më pak të folura apo të mësuara, respekt për diversitetin e gjuhëve për komunikim ndërkulturor dhe ndër-rajonal. Politikën arsimore gjuhësore janë të lidhura ngushtë me arsimin për vlerat demokratike sepse qëllimet e tyre janë plotësuese: mësimdhënia e gjuhëve, si qendra ideale e kontaktit ndërkulturor, është një sektor ku arsimi për jetesën demokratike, në dimensionin ndërkulturor mund të përfshihet në sistemin arsimor.⁷

⁵ Këshilli i Europës, *Kompetencat për Kulturë Demokratike: Jetesa së bashku si të barabartë në shoqëri me diversitet kulturor*, Strasburg: Këshilli i Europës, 2016. E disponueshme në internet në faqen: <http://www.coe.int/en/web/education/competences-for-democratic-culture>

⁷ Shih Shtojcën 1.

⁶ *Nga Diversiteti Gjuhësor te Arsimi Plurilingual: Udhëzues për zhvillimin e politikave arsimore gjuhësore në Europë*. Versioni i rishikuar i botuar më 2007 nga Divizioni i Politikës Gjuhësore, Këshilli i Europës. Udhëzuesi ekziston në versionin "e plotë" dhe "të përmbledhur" për t'iu përshtatur nevojave të lexuesve të ndryshëm. I disponueshëm në faqen: www.coe.int/lang, ai shoqërohet me një seri referencash studimore të cilat ofrojnë analizë të thelluar të çështjeve kryesore të përmendura në versionin e plotë.

⁷ *Nga Diversiteti Gjuhësor te Arsimi Plurilingual: Udhëzues për zhvillimin e politikave arsimore gjuhësore në Europë* (Versioni i plotë), f.36.

Rrjedhimisht politika arsimore gjuhësore e Këshillit të Europës është promovimi i "arsimit plurilingual dhe ndërkulturor" sikurse përkufizohet në dokumentin *Arsimi plurilingual dhe ndërkulturor si një projekt*.⁸

Arsimi plurilingual dhe ndërkulturor duhet të konceptohet si një arsim gjuhësor global, përmes të gjitha gjuhëve të shkollës dhe të gjitha fushave lëndore, gjë që përbën bazën për një identitet të hapur për pluralizmin dhe diversitetin gjuhësor, për sa kohë që gjuhët janë shprehja e kulturave të ndryshme dhe dallimeve brenda të njëjtës kulturë. Të gjitha disiplinat kontribuojnë në këtë arsim gjuhësor nëpërmjet përmbajtjes që përcjellin dhe mënyrave përmes të cilave mësohen.

Duhet të nënvizohet që, ndonëse zhvillimi i plurilinguizmit është një qëllim i pranuar i arsimit gjuhësor, zbatimi i tij vetëm sa ka filluar në shumë kontekste arsimore. Masat mund të jenë pak a shumë kërkuese, p.sh. rregulloret nga ministria në lidhje me kurrikulën, apo format e reja të organizimit, të cilat mund të kërkojnë rregullime të veçanta financiare, apo vendime politike, duke nënkuptuar punë intensive në të gjitha nivelet.

Zbatimi i politikave për zhvillimin e arsimit plurilingual dhe ndërkulturor mund të kryhet në disa mënyra, dhe nuk është domosdoshmërisht një çështje "të gjitha ose asgjë". Reagimet ndaj Profilin të Politikës Arsimore Gjuhësore të çdo vendi të caktuar kanë gjasa të ndryshojnë sipas rrethanave, historisë dhe prioriteteve të vendit.

Gjatë disa dekadave Këshilli i Europës ka zhvilluar një gamë mjetesh dhe programesh për nxitjen e plurilinguizmit. Së fundmi, si kundërpërgjigje për shqetësimet që ekzistojnë në shumë vende anëtare, Këshilli është fokusuar te gjuhët e shkollimit dhe rëndësia e tyre për sukses në arsim, sikurse theksohet në njërin nga Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare.⁹

⁸ Shih *Një Platformë Burimesh dhe Referencash për Arsimin Plurilingual dhe Ndërkulturor*, pjesën "Nxënësi dhe gjuhët e pranishme në shkollë": www.coe.int/lang-platform.

⁹ Rekomandimi CM/Rec(2014)5 për rëndësinë e kompetencave në gjuhën(-ët) e shkollimit për barazi dhe cilësi në arsim dhe për suksesin arsimor.

2 Vështrim i përgjithshëm në arsimin gjuhësor në Shqipëri

Ky kapitull ofron një vështrim përshkrues për situatën aktuale të arsimit gjuhësor në Shqipëri. Ai mbështetet shumë te Raporti Vendor, që duhet lexuar paralelisht me Profilin.

2.1 Gjuhët në Shqipëri

2.1.1 Shqipja

Shqipja, gjuha zyrtare e Republikës së Shqipërisë, përbën një degëzim të veçantë të familjes së gjuhëve indo-europiane. Ajo ka dy dialekte kryesore, gegë dhe toskë, që fliten përkatësisht në veri dhe jug të lumit Shkumbin. Varianti i njësuar i gjuhës u përcaktua në një kongres shkencor të mbajtur në Tiranë më 1972. Aty ishin të përfaqësuara të gjitha trevat shqipfolëse dhe standardi që doli u bë versioni zyrtar i shqipes i pranuar gjerësisht.

Shqipja është gjithashtu gjuha zyrtare e Republikës së Kosovës,¹⁰ dhe flitet gjithashtu edhe në Malin e Zi, Serbi, Maqedoni, Turqi, Itali (Arbëreshët), Greqi (Arvanitasit), si edhe nga bashkësitë e emigrantëve shqiptarë në shumë vende të tjera.

2.1.2 Gjuhët e pakicave

Kushtetuta e Shqipërisë garanton të drejta dhe liri të barabarta, si edhe barazi para ligjit për të gjitha pakicat kombëtare. Në regjistrimin zyrtar të popullsisë më 2011, pakicat përbënin 1.4% të popullsisë së vendit. Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, që është ratifikuar nga Shqipëria¹¹, shërben si themeli për mbrojtjen e pakicave dhe të drejtave të tyre themelore, përfshirë edhe të drejtën për t'u arsimuar në gjuhën e tyre amtare. Ajo shërben gjithashtu si bazë për zbatimin e politikave për pakicat në vend. **Bashkësia greke dhe maqedonase** njihen si pakica etnike dhe **bashkësia rome dhe arumune** si pakica etno-gjuhësore. Ka gjithashtu edhe një **pakicë entike serbo-malazeze** e përqendruar kryesisht në qarkun e Shkodrës. **Gjuha shqipe e shenjave** u njoh zyrtarisht nga qeveria shqiptare më 2014.

2.2 Sistemi arsimor në Shqipëri

2.2.1 Kuadri ligjor dhe administrativ

Institucionet arsimore në Shqipëri, qofshin këto private apo shtetërore, funksionojnë nën juridiksionin e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Sistemi arsimor funksionon në nivelin kombëtar, rajonal dhe shkollor.

¹⁰ Të gjitha referencat për Kosovën në këtë tekst, qoftë si territor, institucione ose popullsi, bëhen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, dhe pa asnjë paragjykim për statusin e Kosovës.

¹¹ Ratifikuar me Ligjin Nr.8496 datë 3.06.1999, i cili hyri në fuqi 01.01 2000.

Në nivelin kombëtar **Kuvendi** miraton programin qeveritar, buxhetin vjetor dhe ligjet specifike, përfshirë edhe ato që kanë ndikim në sektorin arsimor. **Komisioni Parlamentar për Arsimin dhe Median** shqyrton projekt-ligjet para se ato të miratohen nga Kuvendi. **Këshilli i Ministrave** miraton strategjitë kombëtare dhe sektoriale të zhvillimit, kuadrin afat-mesëm të shpenzimeve, dhe projekt buxhetin vjetor të shtetit; ai nxjerr gjithashtu vendime dhe udhëzime për zbatimin e ligjeve. **Ministria e Arsimit dhe Sportit** është institucioni kryesor qeveritar që ka përgjegjësinë për zbatimin e politikës arsimore.

Pesë institute mbështesin zbatimin e politikës arsimore në nivel kombëtar:

- **Instituti për Zhvillimin e Arsimit** ka tri drejtori, atë për kurrikulën, standardet dhe kualifikimin; atë të didaktikës dhe teknologjive të mësimdhënies; dhe atë të zhvillimit të politikave.
- **Agjencia Kombëtare e Provimeve** ka përgjegjësi për hartimin e provimeve shtetërore në sistemin arsimor parauniversitar, për pranimet në arsimin e lartë dhe për provimet shtetërore të profesioneve të rregulluara.
- **Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional (AKAFP)** është përgjegjëse për zbatimin e reformave në arsimin profesional dhe kualifikimet profesionale. Aktualisht, nën juridiksionin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, kjo agjenci harton listën kombëtare të profesioneve dhe kornizën kurrikulare për arsimin dhe kualifikimin profesional; si edhe vlerëson, akrediton dhe certifikon ofruesit e shërbimeve.
- **Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë (AAAL)** është përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë së universiteteve, akreditimin e programit akedemik dhe mbështetjen e universiteteve për vetëvlerësimin.
- **Inspektoriati Shtetëror Kombëtar për Arsimin** është përgjegjës për përmirësimin e cilësisë në shërbimin arsimor parauniversitar si edhe për zbatimin e kërkesave ligjore në arsimin parauniversitar dhe të lartë.

Dymbëdhjetë qarqet e Shqipërisë dhe qyteti i Tiranës kanë secili nga një **Drejtori Arsimore Rajonale (DAR)** (gjithsej trembëdhjetë), të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e politikës arsimore parauniversitare, menaxhimin e burimeve njerëzore, organizimin e planit të inspektiveve në shkollat publike dhe private, vlerësimin e cilësisë së shërbimeve, dhe oraganizimin e kualifikimit të mësuesve në bashkëpunim me institucionet e specializuara. **Zyrat Arsimore (ZA)**, të vendosura në 25 qytete të vendit, janë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në qytetet përkatëse, mbledhjen e informacionit dhe të dhënave statistikore, mbikqyrjen e shkollave dhe veprimtarive të tyre jashtëshkollore dhe menaxhimin e fondeve për një pjesë të sistemit sikurse janë burimet dhe materialet mësimore.

Në nivelin vendor, **Këshillat e Qarkut** të zgjedhura janë përgjegjëse për ndarjen e fondeve të investimeve për bashkitë në fushën e arsimit. **Këshillat Bashkiake** janë përgjegjëse për alokimin e fondeve të buxhetit të shtetit të qeverisë qendrore si grante për mirëmbajtjen e shkollave.

Në nivelin e **drejtorisë së shkollës**, ato janë të përbëra nga një drejtor dhe tri nëndrejtorë (numri i nëndrejtorëve varet nga numri i nxënësve që frekuentojnë shkollën). Drejtorët e shkollave janë përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në shkollat e tyre si edhe për procedurat administrative të përcaktuara nga DAR; ata raportojnë te ZA apo DAR. **Këshillat e Prindërve** janë organe këshilluese që kanë si qëllim të forcojnë marrëdhëniet midis shkollës dhe familjeve të nxënësve. **Bordet e shkollave** janë po ashtu organe këshilluese që kanë si qëllim të përfshijnë bashkësinë dhe sipërmarrjet në zgjidhjen e problemeve në shkollë.

2.2.2 Fazat e arsimit zyrtar

Arsimi parashkollor në Shqipëri është publik dhe privat dhe nuk është i detyrueshëm. Ky arsim përbëhet nga çerdhet (0-3 vjeç) dhe kopshtet (3-6 vjeç) me dhe pa drekë. Çerdhet janë nën administrimin e autoriteteve të qeverisjes vendore, ndërsa kopshtet janë nën menaxhimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. I gjithë arsimi parashkollor bazohet në programe të miratuara nga MAS dhe që kanë si qëllim të nxisin zhvillimin personal të fëmijëve dhe t'i përgatisin ata për shkollën. Gjuhët e huaja nuk janë pjesë e kurrikulës së arsimit parashkollor, ndonëse disa kopshte private ofrojnë elemente të thjeshta të gjuhës së huaj. Kopshtet në zonat e minoritetit ofrojnë mësimdhënie në gjuhën amtare të fëmijëve.

Arsimi bazë i detyrueshëm fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat jo më pak se 9 vjet. Nxënësi është i detyruar të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç. Arsimi bazë përbëhet nga dy cikle: cikli fillor, nga klasa I-V dhe cikli i mesëm i ulët, nga klasa VI-IX. Në **ciklin fillor**, mësimi zhvillohet me bazë klasën, ndërsa në **ciklin e mesëm të ulët**, si rregull, mësimi zhvillohet me bazë lëndën. Në zona të thella ku ka një numër të kufizuar nxënësish, shkolla 9-vjeçare funksionon me klasa të bashkuara. Për klasat e bashkuara I - V, mësimi zhvillohet me një mësues, ndërsa për klasat e bashkuara e VI-IX mësimi zhvillohet nga 2-3 mësues. Arsimi bazë përfundon me Provimin e Lirimit. Që nga 2015 ky provim përfshin tri lëndë të detyrura, gjuhën shqipe, matematikën dhe gjuhën e huaj (anglisht, italisht, frëngjisht ose gjermanisht).

Të gjithë nxënësit që përfundojnë me sukses arsimin bazë kanë të drejtën të ndjekin **arsimin e mesëm**, që zgjat tri vjet dhe përfundon me dhënien e provimit të Maturës Shtetërore. Arsimi i mesëm nuk është i detyruar në Shqipëri. Ka dy lloje shkollash të mesme: gjimnaze të përgjithshme (me kohë të plotë ose të pjesshme) dhe shkolla profesionale. Gjimnazet e përgjithshme u ofrojnë nxënësve një arsim që synon të thellojë dhe zgjerojë njohurinë e përfituar në arsimin bazë. Ka nëntë fusha studimi:

1. Artet
2. Edukimi fizik dhe sportet
3. Gjuhët e huaja
4. Gjuha shqipe dhe letërsia
5. Karriera dhe aftësimi për jetën
6. Matematika
7. Teknologjia & TIK

8. Shkencat natyrore
9. Shkencat shoqërore

Reforma kurrikulare në vijim synon të zhvillojë shtatë kompetencat kyçe:

1. Kumunikimi dhe të shprehurit
2. Të menduarit
3. Të mësuarit
4. Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
5. Personale
6. Qytetare
7. Digjitale

Fushat e studimit janë tkurrur respektivisht në shtatë:

1. Gjuhë dhe komunikim
2. Matematikë
3. Shkenca të natyrës
4. Shoqëria dhe mjedisi
5. Artet
6. Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti
7. Teknologji dhe TIK

Shkollat e mesme me kohë të pjesshme ofrojnë arsimin e mesëm për të rriturit. Kohëzgjatja e studimeve është katër vjet dhe studentët i mbyllin studimet e tyre me dhënien e provimit të maturës shtetërore.

Arsimi profesional u ofrohet të gjithë studentëve që mbarojnë arsimin bazë. Ky arsim synon t'u ofrojë studentëve njohuritë dhe aftësitë praktike të cilat u nevojiten për një jetë profesionale të suksesshme, duke u mundësuar atyre njëkohësisht edhe kualifikimin për pranim në institucionet e arsimit të lartë.

Ligji për Arsimin Parauniversitar u jep **institucioneve arsimore private** të drejtën të operojnë në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Institucionet laike që japin mësim në gjuhën shqipe duhet të miratohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe të licensohen nga Qendra Kombëtare e Licensimit. Institucionet private që japin mësim në gjuhë të huaj dhe institucionet që japin mësim lëndë fetare kanë nevojë për miratim të veçantë nga Këshilli i Ministrave; edhe ato licensohen nga Qendra Kombëtare e Licensimit.

Nxënësit që u përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtën e arsimit në gjuhën e tyre amtare; ata kanë gjithashtu të drejtën të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre brenda kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar.

Arsimi i lartë në Shqipëri përbëhet nga universitetet, akademitë, kolegjet profesionale, shkollat e larta dhe qendrat ndëruniversitare, që ofrojnë programe studimi të akredituara. Gjithsej ka 11

institucione publike dhe 22 private dhe një Qendër për Studimet Albanologjike. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë studime të plota dhe kurse studimore në distancë.

Arsimi i lartë shqiptar është reformuar dhe ristrukturuar sipas parimeve të Procesit të Bolonjës. Studimet organizohen në tri cikle: niveli i parë (bachelor) me tre vite studimi 180 ECTS, niveli i dytë (master) me dy vite studimi 120 ECTS, dhe niveli i tretë (doktoratë). Programet e integruara të studimit në nivelin master kështu kanë 300 ECTS dhe zgjasin pesë vjet. Studimet doktorale bazohen në kërkime shkencore të pavaruara, përfshijnë studime të organizuara me 60 ECTS dhe zgjasin të paktën tri vjet.

Arsimi për të rriturit ofrohet në disa mënyra:

- nëpërmjet programeve të posaçme të arsimit të detyruar që ofrohen për persona në moshë mbi 16 vjeç dhe që nuk e kanë përfunduar arsimin e detyruar;
- nëpërmjet programeve të posaçme të arsimit të mesëm që ofrohen nga gjimnazet me kohë të shkurtuar për persona të rritur dhe që janë të interesuar të përfundojnë arsimin e mesëm;
- nëpërmjet sistemit formal të kurseve të formimit profesional që ofrohen për të rinjtë dhe të rriturit nga sistemi qendrave publike dhe jopublike të formimit profesional, të njohura nga MMSR;
- nëpërmjet programeve formale dhe joformale të zhvillimit profesional që zbatohen nga institucionet publike për trajnimin dhe kualifikimin e personelit të tyre (si p.sh., trajnimet dhe kualifikimet që ofrohen për mësuesit, për policët, për punonjësit e administratës publike, etj.);
- nëpërmjet programeve informale të trajnimit që zbatojnë ndërmarrje dhe biznese private për zhvillimin profesional të personelit të tyre;
- nëpërmjet sistemit joformal të trajnimeve që ofrohen për kategori të ndryshme të të rriturve nga institucione publike dhe jopublike si dhe nga organizata të ndryshme (sidomos projektet e donatorëve dhe OJF-ve);
- nëpërmjet veprimtarive të të nxënësve informal dhe të shkëmbimit të përvojave që ofrohen për të rriturit në forma të shumëllojshme.

2.3 Arsimi gjuhësor në Shqipëri

2.3.1 Shqipja si gjuhë e shkollimit dhe lëndë kurrikulare

Shqipja është gjuha e shkollimit për shumicën dërrmuese të nxënësve; ajo është gjithashtu edhe lëndë më vete në fushën kurrikulare "Gjuhët dhe komunikimi" bashkë me gjuhët e huaja. Kurrikula për gjuhën shqipe synon t'u mundësojë nxënësve:

- të shprehin dhe interpretojnë koncepte, ide, ndjenja, fakte dhe mendime me gojë dhe me shkrim;
- të gjejnë, krahasojnë, analizojnë dhe vlerësojnë lloje të ndryshme informacioni;
- të kuptojnë tipare thelbësore të gramatikës së shqipes;
- të përdorin saktë dhe me përgjegjësi gjuhën në marrëdhëniet shoqërore
- të kuptojnë dhe vlerësojnë tekste nga periudha të ndryshme të letërsisë shqipe.

Shqipëria mori pjesë për herë të parë në anketimin PISA të performancës së nxënësve në shkencë, lexim dhe matematikë në vitin 2000. Që nga ajo kohë, performanca e nxënësve shqiptarë ka treguar një përmirësim të qëndrueshëm. Në anketimin e 2012 Shqipëria ishte një nga tri vendet (dy të tjerat ishin Polonia dhe Izraeli) të cilat treguan rritjen më të lartë në përqindjen e nxënësve që kanë arritur rezultate të larta dhe uljen më të lartë në përqindjen e nxënësve që kanë arritje të ulëta. Shqipëria mbetet sidoqoftë nën mesataren e vendeve të OZhBE (OECD) dhe kjo ka çuar në vendimin e fundit për të ndarë mësimin e gjuhës shqipe nga letërsia me qëllim që t'u lejohet mësuesve të përqendrohen më shumë në zhvillimin e aftësive komunikuese të nxënësve.

2.3.2 Arsimi në gjuhët e pakicave ¹²

Pakica kombëtare greke është në përgjegjësinë e DAR Gjirokastrë dhe të ZA të Sarandës dhe Delvinës. Ka tetëmbëdhjetë klasa/shkolla për minoritetin grek në Delvinë (rreth 118 nxënës), dhe njëzet e katër klasa/shkolla në DAR e Gjirokastrës (227 nxënës). Në këto shkolla, janë të punësuar 78 mësues për të dhënë mësim për një total prej 615 nxënësish. Bazuar në marrëveshjen midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë, të gjithë nxënësit që i përkasin pakicës kombëtare greke që mësojnë në Gjirokastrë, Delvinë dhe Sarandë u ofrohen tekstet shkollore falas.

Për **pakicën maqedonase** ka 19 klasa/shkolla (148 nxënës) në DAR e Koçës, në fshatrat Liqenas, Goricë e Madhe dhe Goricë e Vogël. Klasa të veçanta nuk ofrohen për **pakicën serbo-malazeze**.

Përpjekje të rëndësishme janë bërë në vitet e fundit për të përmirësuar situatën e përgjithshme të **bashkësisë rome** dhe shkollimi i fëmijëve të bashkësive rome dhe egjiptiane ka qenë një prioritet. Është ofruar mbështetje financiare për të nxitur përmirësimin e frekuentimit në shkollë dhe studentët nga këto bashkësi përjashtohen nga tarifat e studimit në arsimin e lartë. Gjuha rome nuk është gjuhë shkollimi, por një departament i gjuhës rome dhe mësimdhënies së saj është hapur kohët e fundit në Universitetin e Elbasanit.

Regjistrimi kombëtar i popullsisë më 2011 evidentoi se ishin 5300 individë me "mungesë totale dëgjimi" në Shqipëri, që është e barabartë me 2.4 për çdo 1000 banorë. Qeveria shqiptare ka njohur zyrtarisht **gjuhën shqipe të shenjave** dhe u ka dhënë nxënësve që nuk dëgjojnë në arsimin parauniversitar të drejtën e komunikimit në këtë gjuhë. Mbi bazën e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe ANAD-it, një grup pune po shqyrton

¹² Shifrat e dhëna në këtë pjesë i referohen vitit akademik 2016–2017.

situatën e personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri. Ajo që premtion të jetë një zhvillim i rëndësishëm është ende në hapat e para.

2.3.3 Gjuhët e huaja në shkollë

Në **arsimin bazë**, një gjuhë e huaj e parë është e detyruar dhe një gjuhë e huaj e dytë është me zgjedhje. Gjuhët që mësohen janë: anglishtja, italishtja, frëngjishtja dhe gjermanishtja. Nxënësit e fillojnë gjuhën e huaj të parë në klasën III dhe vijojnë me të deri në përfundim të arsimit bazë. Nëse nxënësit nuk kanë bërë një gjuhë të huaj në arsimin bazë, ata e fillojnë në arsimin e mesëm të ulët (klasa VI), me një orë mësimi shtesë në javë për të ecur më shpejt. Në klasën VI ofrohet një gjuhë e huaj e dytë si lëndë me zgjedhje. Gjuha e huaj e parë ka tri orë, ndërsa e dyta dy orë në javë.

Aktualisht, diçka më pak se 2% e nxënësve në arsimin bazë nuk bëjnë një gjuhë të huaj, zakonisht për shkak se jetojnë në zona të thella rurale ose për shkak se shkolla e tyre ka shkrirë klasat ose ka mungesë të mësuesve të kualifikuar. Në vitin 2003-2004 kjo shifër ka qenë 11.2%. Ky përmirësim i ndjeshëm që prej asaj kohe ka qenë për shkak të zbatimit të politikave arsimore që kanë nënvizuar vazhdimisht rëndësinë e ofrimit të një gjuhe të huaj për nxënësit, pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike apo kushteve shoqërore.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj në **shkollat e mesme** ndjek planin dhe kurrikulën për shkollat e mesme, shkollat profesionale, shkollat e gjuhëve të huaja dhe seksionet shkollore dygjuhëshe. Programet lëndore bazohen te kurrikula, që nga ana e saj synon të jetë e harmonizuar me Kuadrin e Përbashkët Europian të Referencës për Gjuhët (KPERGj). Nxënësit ndjekin të njëjtën (ose të njëjtat) gjuhë në shkollë të mesme si në arsimin bazë dhe sërish gjuha e huaj e parë është e detyruar ndërsa e dyta është me zgjedhje.

Ka pesë **shkolla të mesme të gjuhëve të huaja** të cilat synojnë t'u ofrojnë nxënësve formim të thelluar në dy a më shumë gjuhë të huaja, përpos kurrikulës së përgjithshme. Këto shkolla ndodhen në Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë dhe Gjirokastrë dhe ato ofrojnë nga dy deri në gjashtë gjuhë të huaja. Ato kanë shërbyer për një kohë të gjatë si shkolla burimore për fakultetet e gjuhëve të huaja, dhe prandaj janë të vendosura në të njëjtat qytete me këto fakultete. Një gjuhë e huaj është një nga tri lëndët e detyruara në Maturën Shtetërore për këto lloj shkollash.

Seksionet shkollore dygjuhëshe ofrojnë arsimin e mesëm në Shqipëri dhe një gjuhë të huaj. Funksionimi i tyre mbështetet në marrëveshje dypalëshe me qeveritë e huaja dhe në një ofrim mësuesish amtarë të gjuhës. Shkollat e kësaj kategorie u kërkojnë nxënësve ta mësojnë gjuhën e huaj në fjalë në mënyrë intensive nga mosha e hershme (aktualisht nga klasa III e arsimit bazë), në mënyrë që të arrijnë kompetencën gjuhësore për të cilën kanë nevojë për të studiuar lëndët kurrikulare nëpërmjet gjuhës së huaj. Deri më tani, ky rregullim ka funksionuar mirë. Nxënësit që ndjekin këto seksione shkollore dygjuhëshe bëjnë një provim të dyfishtë të Maturës shtetërore në të cilin provimet për lëndët që zhvillohen në gjuhë të huaj përgatiten nga Ministria e Arsimit të vendit partner, ose zyra shkollore në Shqipëri ose shërbimi diplomatik. Nxënësit që ndjekin këto

seksione shkollore kanë akses në universitetet e vendit partner, në nivel të barabartë me qytetarët e atij vendi.

Seksioni i parë dygjuhësh (shqip dhe frëngjisht) u themelua më 1998 në Korçë, aty ku ka ekzistuar një lice francez nga 1917 deri më 1939. Më pas, seksionet dygjuhëshe janë ngritur në vijim: shqipfrëngjisht në Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, dhe Shkodër; shqip-italisht në Tiranë, Korçë dhe Shkodër; shqip-gjermanisht në Tiranë. Secili nga këto seksione mbështetet nga dy ose tre shkolla të arsimit bazë në të cilat gjuha e huaj në fjalë jepet mësim intensivisht nga mësues amtarë të gjuhës.

Shkollat e mesme të specializuara për **artet dhe sportet** ndahen në katër lloje: arte pamore të aplikuara (gjashtë degë), muzikë (tre profile arsimore), balet (dy profile arsimore), dhe koreografi (një profil arsimor). Kohëzgjatja e studimeve në këto shkolla është tre ose katër vjet, në varësi të specializimit artistik dhe të moshës/fazave në të cilën nxënësi i fillon studimet e shkollës së mesme. Nxënësit pranohen mbi bazën e testimit të aftësive. Këto lloj shkollash u japin prioritet gjuhëve të huaja për shkak të fokusit të veçantë dhe veprimtarive të veçanta që ato kryejnë në vend dhe jashtë vendit.

Në **arsimin profesional**, një gjuhë e huaj e parë është e detyrueshme dhe një e dytë është me zgjedhje. Dy gjuhë të huaja janë të detyrueshme në shkollën e hotelerisë dhe turizmit.

2.3.3.1 Provimet shtetërore dhe teste të tjera të sanksionuara zyrtarisht

Nxënësit japin Provimin e Lirimit (PL) në fund të arsimit bazë dhe provimin e Maturës Shtetërore në fund të arsimit të mesëm. Që nga futja e saj më 2005, MSh ka pësuar disa ndryshime të cilat kanë synuar përmirësimin e funksionimit të saj. Aktualisht, nxënësit japin provimin në tri lëndë të detyrura, (gjuhë shqipe, matematikë dhe gjuhë e huaj) dhe dy lëndë me zgjedhje. Ata nxënësit që dëshirojnë të ndjekin studimet e larta në Edukimin fizik dhe sporte apo arte të bukura duhet të japin një testim të aftësive profesionale të bërë nga institucionet përkatëse të arsimit të lartë dhe të monitoruar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Gjatë periudhës së vizitës së ekspertëve të Këshillit të Europës, ishte në shqyrtim futja e dy provimeve të njohura ndërkombëtarisht, APTIS for Teens në arsimin bazë (Këshilli britanik) dhe TOEFL Junior Standard në arsimin e mesëm. Në këtë aspekt, sidoqoftë, APTIS for Teens nuk u përdor ndërsa TOEFL Junior Standard u zbatua vetëm për një shkollë dhe nuk do të përdoret në të ardhmen.

2.3.4 Gjuhët e huaja në arsimin e lartë

Një gjuhë e huaj është pjesë e kurrikulës për të gjithë nxënësit që diplomohen nga institucionet publike të arsimit të lartë në Shqipëri; përparësi i jepet gjuhëve angleze, frënge dhe italiane. Ky mësim i gjuhës synon të përmirësojë arsimimin e përgjithshëm të studentëve, të zhvillojë aftësinë e tyre për komunikim dhe t'u japë akses në literaturën shkencore në gjuhën e zgjedhur, si edhe t'u lehtësojë studimin jashtë vendit. Në varësi të strukturave kurrikulare dhe institucionale, një gjuhë e huaj studiohet zakonisht gjatë dy ose tri vjetëve. Gjuha angleze është aktualisht gjuha

mbizotëruese edhe si rezultat i projektit "Shqipëria anglofone", por kohët e fundit ka pasur një rritje të kërkesës për gjuhët fënge, gjermane dhe italiane.

Programe studimi ofrohen për gjuhët e mëposhtme: anglishte, frëngjishte, italishte, gjermanishte, spanjishte, ruseshte, turqishte dhe greqishte; gjuha kineze është futur si gjuhë me zgjedhje. Ka dy Fakultete të Gjuhëve të Huaja, në universitetet e Tiranës dhe Shkodrës. Në pesë universitetet e tjera ka departamente të gjuhës angleze, frënge, gjermane dhe greke. Në përfundim të arsimit të lartë, studentët e gjuhëve të huaja pajisen me diplomë në një nga tri këto fusha: mësimdhënie, përkthim dhe interpretim; komunikim ndërkulturor dhe turizëm.

Kurrikulat e gjuhës së huaj hartohen nga stafi akademik i fakulteteve të gjuhëve të huaja dhe miratohen nga organi i duhur në çdo institucion. Kur futet një program i ri i gjuhëve të huaja në nivelin bachelor, kurrikula është subjekt i miratimit nga Këshilli i Akreditimit për Arsimin e Lartë, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Këshilli i Ministrave.

2.3.5 Formimi i mësuesve të gjuhëve të huaja

Mësuesit e gjuhëve në sistemin shqiptar të arsimit publik e marrin formimin e tyre fillestar në fakultetet e univesiteteve ose departamentet e gjuhëve të huaja. Departamenti i Gjuhëve SllavoBallkanike në Universitetin e Tiranës dhe Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek në Universitetin e Gjirokastrës janë përgjegjës për formimin e mësuesve që punojnë me nxënësit e pakicake kombëtare.

Programet e studimeve në ciklin bachelor tre-vjeçar janë të hartuara për t'u ofruar studentëve arsimim të përgjithshëm në gjuhë të huaj në fushat e mëposhtme:

1. "Gjuhësi, Letërsi dhe Qytetërim" i gjuhës së huaj përkatëse
2. "Përkthim dhe Interpretim"
3. "Gjuhësi dhe Komunikim"

Lëndët pedagogjike mësohen në ciklin e dytë master dy-vjeçar, i pasuar nga praktika në shkolla e monitoruar nga mësues të kualifikuar.

Përpos mësimit të gjuhës B, në të cilën studentët diplomohen, ata mund të zgjedhin edhe një gjuhë tjetër të huaj C (4 ECTS, 40 orë) dhe një të tretë D (4 ECTS, 40 orë) në çdo vit akademik me synimin e arritjes së nivelit KPERGj B1 ose B2.

Duke qenë se mësimdhënia është profesion i rregulluar, studentët duhet të kryejnë ciklin e dytë të studimeve në fushën e mësimdhënies si edhe praktikën profesionale dhe të kalojnë provimin shtetëror. Ata duhet të ndjekin gjithashtu kurse kualifikimi të vazhduar për të mbështetur zhvillimin e tyre profesional në vijimësi. Këto organizohen në nivel kombëtar, rajonal, dhe vendor dhe shpesh edhe me mbështetjen e ambasadave dhe agjensive të huaja të lidhura me to.

2.4 Këshilli i Europës dhe arsimi gjuhësor në Shqipëri

Në 1992 Shqipëria nënshkroi Konventën Europiane Kulturore e cila hapi derën për bashkëpunimin në fusha të veçanta të lidhura me Konventën si për shembull mësimdhënia e historisë dhe e gjuhëve të huaja. Në 1995 Shqipëria u bë shteti anëtar i 35-të i Këshillit të Europës dhe në 2000 Shqipëria u anëtarësua në Qendrën Europiane për Gjuhët Moderne. Që nga përkthimi në gjuhën shqipe dhe botimi më 2007, *Kuadri i Përbashkët European i Referencës për Gjuhët (KPERGj)* është bërë referencë e përhershme në diskutimet për kurrikulën, vlerësimin dhe formimin e mësuesve. Shqipëria, po ashtu, është angazhuar shumë për zhvillimin dhe zbatimin e Portofolit Europian të Gjuhëve. Tri versione shqipe, për nxënësit e moshës 11-14 vjeç, 15+ dhe për studentët 18+, janë zhvilluar, vlerësuar dhe akredituar nga 2008 deri më 2011, si edhe tri versione të tjera janë regjistruar më 2014. Raporti vendor ofron detaje për gjetjet pozitive të sondazhit për përdoruesit e PEGj.

3 Disa çështje për shqyrtim

3.1 Arsyetimi për Profilin e politikës arsimore gjuhësore të Shqipërisë

Sistemi arsimor shqiptar është aktualisht në procesin e një reformimi të thellë dhe kompleks dhe arsimit gjuhësor është fushë me prioritet. Sipas Raportit Vendor, objektivat kryesore të Shqipërisë në kërkesën për asistencë nga Këshilli i Europës për të zhvilluar Profilin e Politikës Arsimore Gjuhësore ishin:

- forcimi i profilit plurilingual dhe multikulturor të vendit;
- përgatitja e një dokumenti që do të mbështesë zhvillimin e politikave të qarta për mësimin e gjuhëve në vend;
- përpunimi i kurrikulave në përputhje me kërkesat europiane dhe kushtet e vendit;
- përcaktimi i përparësive në zhvillimin profesional të mësuesve të gjuhëve.

Ky kapitull është shkruar duke pasur parasysh këto objektiva. Ai reflekton pikëpamjet e Grupit të Ekspertëve për çështje themelore të identifikuar në Raportin Vendor dhe/ose të vetë ekspertëve gjatë vizitës studimore.

3.2 Legjislacioni dhe politika të lidhura me gjuhën

Dispozitat legjislative dhe administrative të Shqipërisë në përgjithësi janë në përputhje me politikat e Këshillit të Europës për arsimin cilësor dhe gjithëpërfshirës. Megjithatë, edhe pse Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare ka hyrë në fuqi që nga viti 2000, Shqipëria nuk e ka nënshkruar ende Kartën Europiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave, ndonëse janë ndërmarrë iniciativa pozitive dhe konkrete për të mbështetur mësimin e gjuhëve të pakicave¹³. Për më tepër, një ligj për pakicat ku të specifikohen të drejtat dhe përgjegjësitë e bazuara në Kushtetutën e Shqipërisë, me fokus dispozitat gjuhësore, nuk e ka kalur ende fazën përgatitore. Por, ka të dhëna të forta politike se këto boshllëqe do të mbushen në të ardhmen e afërt.

Shqipëria i afrohet dhe në disa aspekte i ka arritur tashmë standardet europiane në lidhje me strukturën e sistemit arsimor dhe politikave arsimore. Janë ngritur agjensitë mbështetëse për zhvillimin e kurrikulës dhe të cilësisë, si edhe të provimeve kombëtare; nxënësit që diplomohen në arsimin e mesëm kanë akses të plotë në arsimin e lartë; si edhe po kryhen ende reforma të rëndësishme në fushën e arsimit profesional dhe arsimit për individët me nevoja të veçanta. Gjatë vizitës së tyre, ekspertët e Këshillit të Europës bënë vizita në shkolla në Durrës dhe Tiranë dhe morën pjesë në orë mësimore në gjuhën angleze, frënge, italiane dhe gjermane. Nxënësit që grupi takoi, kishin mjaft interes të bashkëvepronin me ekspertët dhe gjatë këtyre bashkëveprimeve ata treguan nivele jashtëzakonisht të larta në të shprehur.

¹³ Reporti Vendor, Kreu 2.2.5 (www.coe.int/lang → Language Education Policy Profiles → Albania)

Është e rëndësishme të njohim arritjet domethënëse të Shqipërisë në modernizimin e sistemit të saj arsimor në përgjithësi dhe arsimit gjuhësor në veçanti, të arritura në më pak se tri dekada. Rosishtja, si *lingua franca* e vendeve të bllokut lindor, është zëvendësuar nga ofrimi në shkallë të gjerë i gjuhës angleze, frënge, italiane dhe gjermane në shkollat fillore, të mesme të ulta dhe të mesme. Kjo ka kërkuar një përpjekje për reformim të shpejtë, të mbështetur dhe kryesisht vertikale; por pavarësisht arritjeve mbresëlënëse në disa klasa, në mënyrë të pashmangshme mbeten ende një sërë sfidash, shqetësimesh dhe nevojash. Këto duhen trajtuar nëse duam që të zhvillohet cilësia dhe efikasiteti në arsimin gjuhësor në të gjitha nivelet.

3.3 Gjuhët e shkollimit

Shqipja është gjuha kryesore e arsimit në Shqipëri, sikurse u theksua në Kreun 2 dhe ka dispozita ligjore për fëmijët e pakicave kombëtare për t'u arsimuar në gjuhën e tyre amtare; gjuha shqipe e shenjave është e njohur si mjete i përshtatshëm për shkollimin e personave që nuk dëgjojnë. Raporti Vendor këmbëngul në angazhimin e Shqipërisë për zbatimin e politikave të Këshillit të Europës në arsimin gjuhësor, në të cilin, plurilinguizmi luan një rol themelor; prandaj edhe përfshirja e gjuhës shqipe në fushën kurrikulare "Gjuhët dhe komunikimi" shkon qartë në këtë drejtim. Por, angazhimi i plotë për arsimin plurilingual dhe vendosja e plurilinguizmit si kompetencë kyçe do të thotë që të përfshihet si shqipja edhe gjuhët e tjera të instruksionit në bashkëveprim të qartë me gjuhët e huaja në të gjitha nivelet e politikave, kurrikulumit, formimit të mësuesve dhe praktikave në klasë. Kjo nënkupton gjithashtu që të vendoset një theks i ri në dimensionin gjuhësor në të gjithë kurrikulën me qëllimin për të përmirësuar edhe më tej arritjet akademike. Si pjesë e këtij procesi, duhet të shqyrtohet edhe ofrimi i mundësisë së mësimin në gjuhët rome.¹⁴ Puna në këtë fushë duhet të shihet si një dimension thelbësor i "europianizimit" të mëtejshëm të Shqipërisë.

Materialet e zhvilluara nga projekti i Këshillit të Europës, *Gjuhët në Arsim, Gjuhët për Arsim*, synojnë të mbështesin artikullimin e politikës arsimore gjuhësore që e lehtëson qasjen e integruar për mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhëve. Sipas kësaj qasjeje, të gjithë mësuesit, qofshin të gjuhës së shkollimit si lëndë, apo të gjuhës së huaj/së dytë, apo të lëndëve të tjera kurrikulare, kanë një interes dhe përgjegjësi të përbashkët për zhvillimin e kompetencave gjuhësore të nxënësve.¹⁵

Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare për "rëndësinë e kompetencave në gjuhën(-ët) e shkollimit për barazi dhe cilësi në arsim dhe për sukses arsimor"¹⁶ na kujton se "e drejta e arsimimit mund të ushtrohet plotësisht vetëm nëse nxënësi zotëron rregullat specifike gjuhësore që përdoren në shkolla dhe janë të nevojshme për të pasur akses në dije"; si edhe "këto kompetenca gjuhësore janë njëri nga faktorët e suksesit në arsim dhe se ato janë parakushti për të

¹⁴ Këshilli i Europës, *Kuadri Kurrikular për Gjuhë Rome*, (www.coe.int/lang → Romani) i cili bazohet në nivelet e KPERGj A1-B2, mund të jetë i dobishëm në këtë drejtim, sikurse mund të jetë edhe projekti i QEGjM "QualiRom Training and Consultancy":
(<http://www.ecml.at/TrainingConsultancy/QualiRom/tabid/1693/language/en-GB/Default.aspx>)

¹⁵ www.coe.int/lang-platform □ Gjuhët e shkollimit

¹⁶ [Recommendation CM/Rec\(2014\)5](http://www.coe.int/lang-platform)

ndërmarrë arsimim të mëtejshëm akademik profesional apo kualifikues, dhe trajnim, prandaj janë të rëndësishme për pjesëmarrjen në shoqëri dhe gjithëpërfshirjen e qëndrueshme." Rekomandimi ofron edhe bazën politike për rishikimin e politikave gjuhësore kombëtare, si edhe Memorandumi Shpjegues ([Explanatory Memorandum](#)) që ofron gjykime të thelluara për parimet dhe masat që mund të merren.

3.3.1 Shqipja si gjuhë e dytë / e huaj dhe gjuhë e trashëgimisë

Nxënësit e shqipes si gjuhë e dytë / e huaj apo gjuhë trashëgimie ndahen në katër kategori të gjera: diaspora shqiptare në Europë dhe më gjerë, disa pjesëtarë të së cilës kanë gjasa të kthehen në Shqipëri në të ardhmen; pakicat që jetojnë në vend; emigrantët në vend; dhe studentët e shqipes në vende të tjera. Prandaj është e rëndësishme të zhvillohet një plan strategjik për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës shqipe jashtë vendit dhe të bëhen përgatitje për integrimin gjuhësor të fëmijëve të familjeve shqiptare në rast se do të ktheheshin në Shqipëri. Përshkruesit (deskriptorët) që përcaktojnë nivelet e zotërimit në KPERGj nuk janë me specifitime gjuhësore; përshkrimet e niveleve të referencës shtojnë substancë gjuhësore te këto përshkrues, p.sh. gramatikë, fjalor, dhe informacion pragmatik dhe socio-linguistik. Si projekt afat-mesëm, do të ishte shumë shumë i dobishëm zhvillimi i përshkruesve të niveleve të referencës për gjuhën shqipe për të orientuar zhvillimin e kurrikulave, materialet e mësimdhënies, dhe vlerësimin.¹⁷

3.3.2 Sfida e posaçme e arsimit për personat që nuk dëgjojnë

Në Raportin Vendor²² bëhet e qartë se arsimit për personat që nuk dëgjojnë përbën një sfidë të rëndësishme për Shqipërinë. Një sondazh i paradokohshëm për personat që nuk dëgjojnë mbi moshën 18 vjeç zbuloi se 61% ishin analfabetë, 37% kishin vështirësi në të kuptuarin e një teksti në shqip dhe vetëm 2% kishin aftësi të kënaqshme leximi. Të pyetur për të vlerësuar aftësitë komunikuese të mësuesve të tyre, 97% e të pyeturve u përgjigjën se mësuesit e tyre kishin aftësi të dobëta komunikimi dhe 3% e mësuesve të tyre kishin aftësi mesatare komunikimi; asnjë nga të anketuarit nuk i vlerësoi aftësitë e mësuesit si pozitive. Sikurse është shkruar edhe në Kreun 2, mbi bazën e një Marrëveshjeje Bashkëpunimi midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe ANAD-it (Shoqata Shqiptare e Personave që nuk dëgjojnë), një grup pune po hulumton aktualisht gjendjen e personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri. Kur ata u takuan me ekspertët e Këshillit të Europës, anëtarët e kësaj bashkësie shpjeguan se qëllimi i tyre është të përcaktojnë një skemë për trajnimin e folësve (që nuk dëgjojnë) në Gjuhën Shqipe të Shenjave që ata mandej të shërbejnë jo thjesht si asistentë në klasë, por si mësues të GjShSh për mësuesit që dëgjojnë. Kjo është një masë që meriton mbështetjen e plotë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit sepse ajo premtion ta transformojë aksesin e bashkësisë që nuk dëgjon në arsimin qendror, gjë që për Këshillin e Europës është një nga të drejtat themelore të njeriut.¹⁸

¹⁷ www.coe.int/lang-CEFR □ Levels □ Reference Level Descriptions ²²

Reporti Vendor, Kreu 2.2.4

¹⁸ Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolli, Neni 2.

Arritja e një transformimi të tillë nuk do të jetë e thjeshtë. Ashtu si gjuhët e folura, edhe gjuhët e shenjave mësohen në bashkëveprim me njerëzit e tjerë; por duke qënë se shumica e fëmijëve që nuk dëgjojnë linden nga prindër që dëgjojnë, ata nuk mund ta mësojnë lehtësisht në shtëpi gjuhën e shenjave dhe nëse jetojnë në zona të largëta, kontakti i rregullt me njerëz të tjerë që nuk dëgjojnë mund të jetë i vështirë, ose edhe i pamundur. Në disa vende shkollat normale u ofrojnë fëmijëve që nuk dëgjojnë akses në gjuhën e shenjave nëpërmjet anëtarësimit në një bashkësi të regjistruar, por shkolla të tilla nuk ekzistojnë në Shqipëri. Këta faktorë duhet të mbahen parasysh kur të planifikohen dispozitat arsimore për GjShSh. Tanimë janë hedhur themele të rëndësishme. Që nga 2000 ANAD-i po bashkëpunon me Shoqatën Finlandeze të Personave që nuk dëgjojnë dhe Universitetin Humak të Shkencave të Aplikuara (Finlandë). Më 2003, ANAD-i filloi kërkimin dhe dokumentimin e GjShSh; fjalori i parë i gjuhës u botua më 2005 (një botim i dytë pritët të dalë më 2016); si edhe më 2007, një studim i gramatikës së GjShSh u hodh në qarkullim me qëllim vendosjen e një varianti standard.

Këshilli i Europës e njeh gjuhën e shenjave si "një mjet të plotë dhe të natyrshëm të komunikimit të personave që nuk dëgjojnë" (Rekomandimi 1598 (2003) i Asamblesë Parlamentare),¹⁹ dhe këto trajtohen në *Udhëzuesin për Zhvillimin e Politikave Arsimore Gjuhësore në Europë*²⁰ dhe në Studimin Referencë.²¹ PROSIGN, një projekt i Qendrës Europiane për Gjuhët Moderne (QEGjM) nga 2012 deri më 2015, ka ngritur një faqe interneti që përmban: përkufizimet e zotërimit të niveleve KPERGj për gjuhët e shenjave, materiale video dhe linke për projektet dhe veprimtaritë e lidhura me to; një cikël vlerësimi për zotërimin gjuhësor në gjuhën e shenjave; si edhe ide për të përdorur sa më mirë KPERGj në lidhje me gjuhët e shenjave. Programi aktual katër-vjeçar i QEGjM (2016-2020) përfshin projekte për promovimin e përsosurisë në mësimdhënien e gjuhës së shenjave. Ndonëse Shqipëria është anëtare e QEGjM, ajo nuk ka marrë pjesë në asnjë nga këto projekte, që mund të mbështesnin zhvillimet më të fundit në lidhje me GjShSh. Rezultatet e të dyja projekteve mund të përdoren gjithsesi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe ANAD-i.

3.3.3 Mësimi i integruar me gjuhën dhe përmbajtjen (CLIL)

Gjuhët e huaja përdoren si gjuhë mësimi në seksionet dygjuhëshe të shkollave të mesme dhe në takimin e tyre me ekspertët e Këshillit të Europës, përfaqësuesit e shoqatave të prindërve shprehën interes të madh për zgjerimin e mësimnxënies së integruar në shkolla në përgjithësi. Një mënyrë për të ecur përpara në këtë drejtim mund të jetë futja e një skeme për trajnimin e veçantë të mësuesve e cila do të shfrytëzonte faktin se një gjuhë e huaj është pjesë e detyruar e kurrikulës universitare për studentët në të gjitha fakultetet, duke krijuar kështu një kontigjent me mësues shqiptarë të aftë për të dhënë mësim në disa lëndë në gjuhën e huaj të zgjedhur prej tyre.

¹⁹ Rekomandimi 1598 (2003) për mbrojtjen e [gjuhës së shenjave \(Sign languages\)](#) në shtetet anëtare të Këshillit të Europës.

²⁰ Shih Shtojcën 2: Nga Diversiteti Gjuhësor te Arsimit Plurilinal: Udhëzues për Zhvillimin e Politikave Arsimore Gjuhësore në Europë - Kreu 4.1.1.1.

²¹ L. Leeson, [Gjuhët e Shenjave në Arsimin në Europë – një shpjegues paraprak](#), Strasburg: Këshilli i Europës – Politika Gjuhësore, 2006.

Investimi i Shqipërisë në seksionet dygjuhëshe të shkollave të mesme dhe në mësimdhënien e integruar (CLIL) ngre pyetjen: Me sa efektivitet i përdor dhe i ndërton më tej arsimit të lartë kompetencat në gjuhë të huaja të zhvilluara në shkollë? Në sektorin privat është e mundur të marrësh një diplomë të përbashkët, kryesisht në shqipe dhe italishte; ndoshta universitetet publike duhet të nxiten të ofrojnë programe dygjuhëshe në shqip/anglisht, shqip/frëngjisht, shqip/gjermanisht dhe shqip/italisht. Futja e këtyre programeve do ta përmirësonte cilësinë e ofrimit të arsimit të lartë si edhe do të zgjeronte gamën e mundësive të ofruara për studentët.

3.4 Reforma kurrikulare në gjuhët e huaja dhe tekstet

Fusha arsimore e gjuhëve të huaja ka qenë në një situatë reformimi pak a shumë të vazhdueshëm që nga mesi i viteve 1990-të. Në vitin 2000, Ministria e Arsimit dhe Sportit miratoi futjen e kurrikulës kombëtare me bazë përmbajtjen, e cila u zëvendësua më 2005 nga kurrikula me bazë objektivat, që aktualisht po zëvendësohet nga kurrikula me bazë kompetencat. Përfaqësuesit e prindërve që u takuan me Grupin e Ekspertëve shfaqnin dukshëm një lodhje nga reformat, dhe nga diskutimet me mësuesit, ekspertët nuk ia dolën të nxirrnin qartë se në çfarë mase reformat e njëpasnjëshme kurrikulare kanë çuar në ndryshimin e mësimin në klasë. Sipas Raportit Vendor, reforma kurrikulare në gjuhët e huaja është udhëhequr nga *Kuardi i Përbashkët European i Referencës për Gjuhët* që nga përkthimi i këtij dokumenti më 2007.²² Kjo reflektohet qartë në orientimin e përgjithshëm të reformës në vijim. Megjithatë, studiet e mëtejshme të reformës mund të kenë më shumë përfitime nga një reflektim më i thellë i ndikuar jo vetëm nga KPERGj, por edhe nga dokumentet e tjera të hartuara nga Programi i Politikës Gjuhësore.²⁸ Dokumenti i botuar së fundmi, *Udhëzues për Zhvillimin dhe Zbatimin e Kurrikulave për Arsimin Plurilingual dhe Ndërkulturor* (2016), për shembull, ofron udhëzime dhe burime të cilat mund të jenë veçanërisht të dobishme.

Është e rëndësishme të pranojmë se reforma kurrikulare ka - ose duhet të ketë - pasoja të rëndësishme në praktikën pedagogjike. Tek e fundit, është një udhë e gjatë nga mësimdhënia gramatikë-përkthim dhe vlerësimi drejt mësimdhënies, strategjive dhe standardeve të vlerësimit të cilat fokusohen te zhvillimi i kompetencave të nxënësit. Qasja me bazë kompetencat është mjaft e ndërlikuar dhe presupozon një të kuptuar të thelluar të parimeve social-konstruktiviste të mësimin të gjuhës dhe implikimet e tyre për rolin e mësuesve dhe nxënësve. Kjo ngre pikëpyetje të rëndësishme për natyrën e njohurisë ("kompetencën") që mësimdhënia e gjuhës duhet të kërkojë dhe zbatimin e suksesshëm i kësaj qasjeje varet nga nxënësit që mësojnë dhe shfrytëzojnë strategjitë dhe aftësitë për mësimin e gjuhës. Me fjalë të tjera, reforma kurrikulare aktualisht në vijim ka nevojë për një rishqyrtim kritik të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit të gjuhës në të gjitha nivelet e sistemit arsimor. Kjo do të ketë ndikim të thellë edhe te formimi i mësuesve të gjuhës.

²² [*Kuadri i përbashkët european i referencës për gjuhët: të mësuarit, të nxënë, vlerësimi*](#) ²⁸
Shih Shtojcën 2 (pjesën 5).

Miratimi i kurrikulës me bazë kompetencat është qartësisht në përputhje me dëshirën për t'i pajisur qytetarët me aftësitë të cilat u nevojiten atyre për të pasur sukses në një Europë multikulturale gjithnjë e më konkurruese. Kjo dëshirë mund të shpjegojë gjithashtu vendimin për të përdorur tekste shkollore të prodhuara për tregun ndërkombëtar nga botues të huaj. Këto tekste shkollore kanë avantazhin e pamohueshëm se janë të shkruara nga folës amtarë të gjuhës në fjalë, por nuk ka garanci se ato janë të përshtatura për një model me bazë kompetencat. Sidoqoftë, parimet e plurilinguizmit dhe ndërkulturalizmit kërkojnë që mësimi i gjuhës së huaj të marrë parasysh interesat dhe pritshmëritë e nxënësve në kontekstin e tyre kulturor. Materialet e shkruara nga folësit amtarë për tregun ndërkombëtar mund të ofrojnë origjinalitetin e folësit amtar dhe mund të pasurojnë të kuptuarin e studentëve për kulturën e bashkësive të gjuhës së synuar, por ato nuk mund të marrin në konsideratë kontekstin kulturor shqiptar në lidhje me gjuhën e synuar. Është thelbësore për parimet e Këshillit të Europës që plurilinguizmi dhe multikulturalizmi të përfshijnë edhe gjuhën dhe kulturën e vetë nxënësit.

Sistemi kurrikular shqiptar - kuadri i përgjithshëm, programet lëndore, direktivat për zbatimin e përgjithshëm dhe direktivat për lëndë të veçanta - nuk shkon deri në nivelin e ulët të planifikimit dhe vlerësimit (njësitë mësimdhënëse dhe mësimet) në shkolla. Një mënyrë për ta ndrequr këtë mangësi do të ishte që t'u jepej fuqi mësuesve të gjuhëve të përcaktonin kurrikula me bazë kompetencat specifike për shkollën: plane pune që synojnë të pasurojnë veprimtaritë e bazuara te tekstet duke shtuar kontekstin social kulturor përkatës. Shkollave mund t'u ofrohet një tabelë e përbashkët për të zhvilluar plane pune si edhe një manual që shpjegon se përse është e mirë tabela dhe si ta përdorin atë. Me kohë, nga mësuesit mund të pritët të bazojnë (le të themi) 70% të mësimdhënies së tyre në tekste shkollore me materiale mësimore të krijuara paraprakisht dhe pjesa tjetër me materiale të përshtatura për kontekstin shqiptar. Këto rregullime do të ishin plotësisht të harmonizuara me strukturën e sistemit arsimor: kurrikula përcaktohet në nivelin qendror, çështjet administrative trajtohen në nivel vendor dhe cilësia e mësimdhënies është përgjegjësi e shkollës përkatëse.

3.4.1 Mësimdhënia e gjuhës në moshë të hershme

Në Shqipëri, pjesa dërrmuese e nxënësve e fillojnë mësimin e gjuhës së parë të huaj në klasën III të shkollës fillore. Kjo ishte rezultat i një përpjekjeje reformuese kryesore që u realizua në një periudhë kohore, për të cilën autoritetet shqiptare meritojnë vlerësimin më të lartë.

Ndonëse grupi i ekspertëve nuk vizitoi ndonjë orë mësimore të gjuhës së huaj në shkollën fillore, vëzhgimet e mëposhtme duket se janë të përshtatshme. Gjatë dy dekadave të fundit, shumë vende europiane kanë futur mësimin e gjuhës së huaj në moshë të hershme dhe përvoja ka treguar se qasjet pedagogjike të përshtatshme për fëmijët midis moshës 6 dhe 10/11 vjeç ndryshojnë në një sërë mënyrash nga qasjet e përdorura përgjithësisht në asrimin e mesëm të ulët. Kjo ngre tri çështje për autoritetet shqiptare. Së pari, çfarë lloj formimi fillestar për mësuesit dhe mentorimi pasues me bazë detyrat nevojiten me qëllim që të përcaktohet një profil profesional specifik për mësuesit e gjuhës së huaj në nivelin fillor? (Minimalisht profili duhet të përfshijë një nivel të lartë të zotërimit të gjuhës së huaj përkatëse dhe një njohuri të thelluar të zhvillimit psiko-social të nxënësve të vegjël.) Së dyti, a duhet të ftohen ekspertë nga vende të tjera europiane me përvojë të gjatë në

fushën e mësimdhënies në moshë të hershme për të mbështetur një program për kurse pa shkëputje nga puna për mësuesit e gjuhëve të cilët janë të kualifikuar për mësimdhënie në nivelin e mesëm të ulët? (Vlen të nënvizohet në këtë pikë se disa projekte të fundit të QEGJM kanë zhvilluar instrumente dhe burime për mbështetjen e mësimdhënies në moshë të hershme.) Dhe së treti, si mund t'u ofrohen tekste dhe materiale mësimdhënieje shkollave të përshtatura për nevojat e nxënësve të vegjël?

3.4.2 Gjuhët e huaja në arsimin profesional

Në shkollat e mesme profesionale, gjuhët e huaja mësohen me dy objektiva në mendje: për të përgatitur nxënësit për arsimin e lartë në pothuajse të njëjtën mënyrë si llojet e tjera të shkollave të mesme dhe për të zhvilluar aftësitë e nevojshme për tregun e punës si në rastin e programit "English for Skills" të Këshillit Britanik, i cili mësohet për katër muaj para provimit të Maturës Shtetërore. Një problem që ndeshet nga mësuesit e gjuhës së huaj në këtë fushë është fakti se përgjegjësia është e ndarë midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale; një tjetër problem është prirja e raportuar se mësimi të gjuhëve i jepet përparësi vetëm në fushën e menaxhim-turizmit dhe TIK. Sistemet e tjera arsimore në Europë kanë ndeshur në probleme të ngjashme me ato që po ndesh Shqipëria. Zgjidhja e tyre ka qenë zhvillimi i strategjive praktike dhe të forta për të harmonizuar kërkesat e arsimit të përgjithshëm dhe profesional duke riorganizuar kuadrin kurrikular dhe sistemin e provimeve nën një ministri si edhe përfshirjen e ministrive dhe agjensive të tjera (dhomat e tregtisë, punëdhënësit, sindikatat) në procesin e vendim-marrjes dhe zhvillimin e programeve lëndore për fushat lëndore përkatëse. Shembuj mund të gjenden në Austri, Gjermani dhe Hollandë.

3.5 Vlerësimi në gjuhën e huaj

Provimi i Lirimit kryhet në fundin e arsimit të detyruar në mbarim të klasës IX dhe Provimi i Maturës Shtetërore në përfundim të shkollës së mesme. Për të gjitha lëndët, të dy provimet kanë nga 13 pyetje me alternativa dhe 12 pyetje të hapura; provimet zgjasin përkatësisht dy orë dhe dy orë e gjysmë. Provimi i Lirimit është i shkallës së ulët sepse rezultatet e tij nuk kanë ndikim në frekuentimin e nivelit pasues arsimor, ndërsa Matura Shtetërore është e shkallës së lartë sepse rezultatet e saj kanë impakt të drejtpërdrejtë në arsimimin e mëtejshëm dhe në mundësitë e karrierës në të ardhmen. Në gjuhët e huaja, të dy provimet përqendrohen ekskluzivisht në lexim dhe shkrim. Kjo do të thotë se ato nuk mund të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme mësimin që një kurrikul me bazë kompetencat synon të promovojë. Kjo është një sfidë kryesore për sistemin shqiptar. KPERGJ i ndërthur sëbashku kurrikulën, të mësuarit/nxënimit dhe vlerësimin në ndërvarësi më të ngushtë se ato kanë qenë tradicionalisht më parë. Me qëllim që të përmbushë ambicjen e kurrikulës me bazë kompetencat, Shqipëria ka nevojë të angazhohet për ndërtimin afat-gjatë të kapaciteteve në testimin dhe vlerësimin e gjuhës.

Sipas Raportit Vendor, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjensia Kombëtare e Provimeve kanë vendosur të ofrojnë teste të huaja për zotërimin e gjuhës si pjesë e Provimit të Lirimit dhe Maturës Shtetërore. Kur zhvillohen në Europë këto lloj testesh rakordohen me KPERGJ dhe një argument

në favor të tyre është se ato do të mbështesin certifikimin në pajtim me standardet e kërkuara për pranimin në universitete të huaja. Seksionet shkollore dygjuhëshe në frëngjisht, italisht dhe gjermanisht tanimë përdorin teste nga Franca, Italia dhe Gjermania, por ky është rast i veçantë. Suksesin në testimin e gjuhës frënge, italiane dhe gjermane u mundëson studentëve shqiptarë të garojnë për një vend në universitet në Francë, Itali dhe Gjermani në nivel të barabartë me bashkëmoshatarët e këtyre vendeve. Sidoqoftë, për sa i takon sistemit arsimor shqiptar në përgjithësi, i njëjti argument vlen për testet e huaja sikurse është përdorur në seksionin 3.4 për tekstet e huaja. Në thelb, një kurrikul shqiptare kërkon një vlerësim shqiptar, dhe nxënësit që përfundojnë shkollën duhet të kenë mundësinë të bëjnë një test vlerësimi të arritjeve të tyre të bazuar fort në kurrikulën me të cilën ata kanë studiuar.

3.6 Formimi i mësuesve të gjuhëve të huaja

Sipas Raportit Vendor, afërsisht 700 studentë pranohen në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja çdo vit (ky numër përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit). Deri në vitin 2016-2017 fakulteti nuk i përcaktonte kriteret e pranimit të studentëve, të cilët mund të regjistroheshin edhe pa e njohur gjuhën përkatëse. Kjo shkaktoi shqetësime serioze në cilësinë e studentëve të rregjistruar dhe kontribuoi në shkallën e lartë të moskalueshmërisë. Kur stafi akademik i fakultetit u takua me ekspertët e Këshillit të Europës, ata argumentuan se studentët duhet të pranohen vetëm nëse ata kanë një nivel B1 të certifikuar të zotërimit të gjuhës së përzgjedhur. Grupi i ekspertëve beson se do të ishte e duhur të kërkohej një nivel më i lartë zotërimi i gjuhës për pranimin në nivelin pasuniversitar të studimeve (ciklin master) në mësimdhënien e gjuhës së huaj.

Arsimi universitar është përgjithësisht akademik jo profesional nga natyra. Kjo shpjegon pse në shumë vende formimi i mësuesve është përgjegjësi e njëjësive të specializuara, shpesh të vendosura në universitete. Në Shqipëri, formimi fillestar i mësuesve është i vendosur në një trajektore arsimore të përcaktuara nga procesi i Bolonjës. Duhet të shqyrtohet mundësia e zhvillimit të një programi trajnimi pasuniversitar për mësuesit i menaxhuar nga akademikë me përvojë të mëparshme në mësimdhënien shkollore / ose me përfshirje të vijueshme në kërkimet me bazë shkollë apo zhvillimin profesional. Me një program të tillë, do të ishte e nevojshme të bëhen përgatitje më vete për nivelet e ndryshme të arsimit parauniversitar. Sikurse është thënë në pjesën 3.4.1, përdorimi i mësuesve të trajnuar në pedagogjinë e arsimit të mesëm të ulët për të dhënë mësim për nxënësit e vegjël, kjo shpërfill nevojat specifike të fëmijëve dhe mund të ketë lehtësisht efekt negativ për suksesin e mësimdhënies në moshë të hershme. Faktorë të tjerë specifike për përmbajtjen që duhen shqyrtuar kur hartohet kurríkula për formimin e mësuesve, përfshijnë procedurat për mësimdhënien me klasa të mëdha dhe/ose me nivele të përziera, praktika përsiatëse, dhe promovimi i formave të ndryshme kërkimore për mësuesit.

3.6.1 Përzgjedhja, vlerësimi dhe mbajtja e mësuesve të gjuhëve të huaja

Nevoja për mësues të gjuhëve me cilësi të lartë në të gjitha nivelet e sistemit është një argument për kërkimin e nivelit minimal të zotërimit për pranimet në programet e ciklit të parë dhe të dytë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Pas tri vite studimesh universitare dhe dy vite pasuniversitare,

mësuesve të mundshëm u kërkohet të shpenzojnë një vit shtesë si praktikantë në një shkollë. Mundësitë për mentorim janë të kufizuara dhe duket se disa të diplomuar nuk kanë mundësi të gjejnë një shkollë ku të mund të punojnë. Ata që kalojnë provimin e licensimit dhe akreditimit në përfundim të periudhës së mentorimit, listohen për arsye punësimi. Kjo masë është futur së fundmi në dobi të transparencës dhe për të eliminuar korrupsionin.

Për sa i takon vlerësimin për akreditimin, grupi i ekspertëve beson se duhet të shqyrtohet në mënyrë të dobishme futja e një portofoli reflektues që mund të përfshijë mendimet e nxënësve dhe mentorëve, si edhe raportin dhe angazhimin kritik të vetë praktikantit për përvojën e tij gjatë periudhës së mentorimit.

3.6.2 Formimi i mësuesve dhe roli i shoqatave të mësuesve

Raporti Vendor ofron një panoramë të detajuar të formave të ndryshme të formimit fillestar dhe të vazhduar të mësuesve të gjuhëve në Shqipëri, por shkalla sipas së cilës ofrimi aktual është i udhëhequr nga implikimet pedagogjike të reformës kurrikulare është e paqartë. Është e rëndësishme të pranojmë se mësuesit mund të angazhohen edhe vetë në zhvillimin profesional në një larmi mënyrash - duke ndjekur kurse në Shqipëri ose jashtë, ose duke marrë rol udhëheqës në zhvillimet me bazë shkollën, apo duke luajtur një rol aktiv në shoqatat profesionale. Kjo ngre pyetjen: si mund të merren parasysh këto veprimtari kaq të ndryshme për zhvillimin e profilit të karrierës së certifikuar të mësuesit? Një portofol reflektues në të cilin mësuesit të regjistrojnë dhe të angazhohen në mënyrë kritike për përvojën e tyre në klasë dhe zhvillimin profesional sërish mund të jetë një pjesë e përgjigjes.

Shqipëria është me fat që ka shoqata aktive dhe të suksesshme mësuesish që mbështesin zhvillimin e arsimit të gjuhëve të huaja në dy mënyra: drejtpërsëdrejti, duke organizuar konferenca, seminare dhe sesione trajnuese dhe indirekt nëpërmjet lidhjeve ndërkombëtare të cilat ato kanë vendosur duke ftuar ekspertë të huaj për të kontribuar në aktivitetet e tyre. Në 2014, p.sh. ELTA fitoi IATEFL²³ dhe Çmimin Trajnimi Ndërkombëtar në Shtëpi (International House Training Award). Ky përfshinte edhe financimin për të sjellë një trajnues ndërkombëtar për mësuesit nga Mbretëria e Bashkuar për të trajnuar trajnuesit shqiptar të mësuesve (anëtarë të ELTA-s) në qarqe të ndryshme të vendit. Trajnimi u bazua në nevojat specifike të anëtarësisë së ELTA-s dhe përmbajtja u ndërtua bashkërisht nga anëtarët e ELTA-s dhe International House (Shtëpia Ndërkombëtare) në Londër. Si pjesëtare e IAETLF, ELTA ka akses në informacionin dhe idetë nga mbarë bota si edhe mundësi të tjera për bursa për të mbështetur zhvillimin profesional të anëtarëve të saj. Ministria e Arsimit dhe Sportit mund të shqyrtojë vendosjen e një bashkëpunimi me shoqatat e mësuesve në një formë më zyrtare, ndoshta në formën e një memorandumimi mirëkuptimi.

²³ Shoqata Ndërkombëtare e Mësuesve të Anglishtes si Gjuhë e Huaj (IATEFL).

Është me vlerë të theksojmë se QEGjM në Graz²⁴ dhe Programi i Politikës Gjuhësore në Strasburg²⁵ kanë zhvilluar burime të cilat mund të mbështesin një rishikim dhe reformim të arsimit të mësuesve të gjuhës.

3.7 Zhvillimi i cilësisë

Në Shqipëri, po ashtu si në sistemet arsimore të vendeve të tjera europiane, përgjegjësia për zhvillimin e cilësisë ndahet vertikalisht dhe horizontalisht: vertikalisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nëpërmjet Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore deri te drejtoritë e shkollave të veçanta; dhe horizontalisht përmes agjensive të ndryshme mbështetëse për arsimin parauniversitar të cilat funksionojnë nën varësinë e Ministrisë dhe përgatisin terrenin për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm. Kjo ndërthurje strukturore kërkon që kriteret transparente të cilësisë dhe procedurat e besueshme të ndahen nga agjensitë në të gjitha nivelet.

Për sa i takon mësimin të gjuhëve të huaja, një numër pikëpyetjesh në lidhje me cilësinë ofrohen për shqyrtim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe grupet e tjera të interesit në arsimin gjuhësor:

- Në çfarë shkalle korrespondojnë me standardet e kurrikulës me bazë kompetencat formatet e testimeve dhe nivelet e arritjeve të provimeve shtetërore (PL dhe MSh) për gjuhët e huaja?
- Në çfarë shkalle dhe në çfarë mënyre përdoren skemat përshkruese dhe nivelet e zotërimit të KPERGj (A2/B1, B2/C1) për të orientuar hartimin, administrimin dhe korigjimin e provimeve kombëtare? Në këtë drejtim duhet theksuar që, me qëllim për të nxitur koherencën dhe transparencën në nivel europian, Këshilli i Europës ofron një gamë të gjerë mjetesh për të ndihmuar agjensitë e provimeve dhe të vlerësimit për të rakorduar provimet dhe testimet e tyre me nivelet e zotërimit të KPERGj.³²
- Si mund të përdoret ekspertiza psikometrike e Agjensisë Kombëtare të Provimeve për të ndihmuar ekspertët gjuhësorë të Institutit për Zhvillimin e Arsimit si dhe ofruesit e formimit të vazhduar të mësuesve të gjuhës për të zhvilluar strategji të bazuara në të dhëna për të përmirësuar mësimdhënien e gjuhëve si edhe për të dizenuar dhe ofruar programe mbështetjeje rajonale dhe kombëtare?
- A u ofrohet mësuesve trajnimi dhe mbështetja e nevojshme për të marrë përgjegjësi për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies në nivel shkolle apo në nivel rrjeti shkollash? A është e mundur që portofoli reflektiv i përmendur në pjesën 3.6.1 të luajë një rol në përmirësimin e mësimdhënies?

²⁴ www.ecml.at

²⁵ Shih, psh, [Teacher education: Language issues in multilingual educational contexts – Sensitising subject student teachers for language issues and cultural perspectives](#); (Platform of Resources... www.coe.int/lang-platform □ Languages of schooling)³²
www.coe.int/lang-CEFR □ Evaluation

- Provimi i akreditimit që mësuesit e ardhshëm japin në fund të procesit të mentorimit teston dijet dhe kompetencat e përfituara gjatë ciklit të parë dhe të dytë të studimeve universitare. A mos është më mirë që të shqyrtohet mundësia e heqjes së këtij dublikimi përmes një procesi vlerësimi që përqendrohet te aftësitë mësimdhënëse gjuhësore dhe aftësia profesionale?

3.8 Partneritetet dypalëshe

Shumë mbështetje për arsimin në gjuhët e huaja në Shqipëri buron nga marrëveshje dypalëshe dhe memorandume mirëkuptimi me ambasada dhe agjensi e institucione të tjera kulturore. Projekte individuale - p.sh. seksionet shkollore dygjuhëshe, shkollat e mesme të gjuhëve të huaja, dhe shkollat në zona të largëta - janë përfituese të investimeve të konsiderueshme të huaja në forma nga më të ndryshmet: mësues të dërguar, asistentë mësues vullnetar, ekspertë vizitues, pajisje dhe media. Vendimet në lidhje me seksionet dygjuhëshe merren në mënyrë të përbashkët nga përfaqësuesit e vendeve në fjalë dhe MAS.

4 Vështrimi nga e ardhmja

Ky kapitull përmban disa propozime për reflektim dhe masa të mundshme për çështjet e ngritura nga ekspertët e Këshillit të Europës të përmbledhura në Kreun 3. Kapitulli mbështetet te besimi se në vijimësinë e procesit të raportuar në këtë Profil, Shqipëria do të përpiqet të arrijë përfitimin maksimal nga instrumentet e politikave të Këshillit të Europës dhe projektet e QEGJM.

4.1 Legjislacioni dhe politika të lidhura me gjuhën

Duhet shqyrtuar mundësia që Shqipëria të nënshkruajë Kartën Europiane për Gjuhët Rajonale dhe të Minoriteteve.²⁶ Kjo do të ndihmonte në konsolidimin e bazës ligjore për zhvillimin dhe zbatimin e një politike sociale që mbështet multilinguizmin dhe një politike arsimore që promovon plurilinguizmin (shih posaçërisht Nenin 8 të Kartës). Hartimi dhe miratimi i një ligji për të drejtat gjuhësore të minoriteteve në nivel kombëtar do të ishte mbështetje për këtë proces. Në të njëjtën kohë, mund të merren masa të dobishme për të ndërgjegjësuar të gjitha grupet e interesit për dokumentet e Këshillit të Europës për politikën arsimore gjuhësore si edhe lidhjen e tyre me dokumentet përkatëse të lëshuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

²⁶ www.coe.int/minlang

4.2 Gjuhët e shkollimit

4.2.1 Shqipja

Projekti i Këshillit të Europës *Gjuhët në Arsim, Gjuhët për Arsim*, ka nënvizuar se arsimi plurilingual nënkupton lidhje të forta midis gjuhës së huaj dhe të dytë të kurrikulës si edhe me dimensionin gjuhësor të lëndëve të tjera (shih Shtojcën 2 për listën e plotë të instrumenteve dhe burimeve të Këshillit të Europës). Një hap i parë në vendosjen e një lidhjeje të tillë do të ishte përfshirja e të gjitha grupeve të interesit në një hulumtim se si të krijohet një ndërveprim frytdhënës midis të gjitha gjuhëve të pranishme në shkollë: shqipja si gjuhë e shkollimit, gjuha e parë dhe e dytë të kurrikulës (përfshirë edhe gjuhët e pakicave), dhe gjuhët e folura nga nxënësit jashtë shkollës por të pa përfshira në kurrikul.

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka zhvilluar tanimë materiale për të mbështetur mësimin e gjuhës shqipe si gjuhë shkollimi për pjesëtarët e diasporës shiptare, si edhe trajnimi i vazhduar i mësuesve ofrohet në një seminar vjetor prej 3-4 ditësh. Mbështetje ofrohet edhe për folësit e shqipes në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovë, Malin e Zi dhe Zvicër (librat jepen falas për nxënësit). Për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj mbështetjeje mund të përdoren burimet dhe dokumentet e Këshillit të Europës. Për shembull, është e mundur të përdoret KPERGj për të prodhuar një dokument që do të udhëhiqte zhvillimin e programeve specifike për mësimdhënien dhe mësimnxënien, zhvillimin e materialeve mësimore si edhe dizenjimin e instrumenteve të vlerësimit. Ky dokument mund të ndjekë shembullin e *Kornizës Kurrikulare të Gjuhëve Rome*²⁷ duke u bazuar te veprimtaritë gjuhësore komunikative të përshkruara në Kreun 4 të KPERGj, por duke e plotësuar edhe me shtimin e elementeve specifike gjuhësore sikurse specifikohe në Kreun 5.

4.2.2 Gjuhët rome

Sikurse raportohet në pjesën 2.3.2, janë ndërmarrë hapa të rëndësishme për të përmirësuar gjendjen arsimore të popullsisë rome. Janë bërë përpjekje për të nxitur frekuentimin e rregullt të shkollës, edhe nxënësit romë i marrin tekstet shkollore falas. Hapi tjetër është trajtimi i çështjes gjuhësore, prandaj për këtë qëllim Ministria e Arsimit dhe Sportit mund të fillojë duke ndërmarrë një hulumtim për gamën e sfidave që përfshihen në këtë aspekt. Mbështetje mund të përfitohet edhe nga oferta e QEGjM Konsultim dhe Trajnim QauliRom (QualiRom Training and Consultancy), e cila kërkon të promovojë arsimin cilësor në gjuhët rome nga perspektiva e të drejtave të njeriut.²⁸ Po ashtu, mund të përdoret edhe *Korniza Kurrikulare për Gjuhët Rome (Curriculum Framework for Romani)*, modelet e Portofolit European të Gjuhëve të zhvilluara për moshat 6-11 dhe 11-16 vjeç³⁶, si edhe materialet mësimore të prodhuara nga projekti QualiRom i QEGjM të KE²⁹.

²⁷ <http://rm.coe.int/a-curriculum-framework-for-romani-developed-in-co-operation-with-thee/16805a2ab9>.

²⁸ <http://www.ecml.at/TrainingConsultancy/QualiRom/tabid/1693/language/en-GB/Default.aspx>

³⁶ Këto dokumente janë të disponueshme në: www.coe.int/lang → Romani

²⁹ qualirom.uni-graz.at

4.2.3 Gjuha shqipe e shenjave

Pjesa 3.3.2 i referohet progresit të madh të arritur në këtë fushë, që përfshin edhe vendimin për ta shndërruar Institutin e fëmijëve që nuk dëgjojnë në një qendër burimore. Ministria e Arsimit dhe Sportit do të vijojë të nxis zhvillimin e kurrikulës, programeve dhe materialeve mësimore për fëmijët që nuk dëgjojnë në shkolla (përfshirë shkollat e mesme) dhe universitete. Do të krijohen gjithashtu edhe mundësi trajnimi për asistentë dhe interpretë të cilët lehtësojnë komunikimin midis nxënësve që nuk dëgjojnë dhe mësuesve, si edhe midis individëve që nuk dëgjojnë dhe komunitetin ku jetojnë. Këto zhvillime mund të përdorin në mënyrë të dobishme materialet e zhvilluara nga projekti PROSIGN³⁰ i QEGJM dhe Shqipëria duhet të kërkojë të përfshihet në mënyrë më aktive në veprimtaritë vijuese dhe të ardhshme të QEGJM në këtë fushë.

4.2.4 Mësimi i integruar me gjuhën dhe përmbajtjen (CLIL)

Sikurse theksohet në pjesën 3.3.3, edhe pse disa shkolla kanë seksione dygjuhëshe, mësimdhënia e integruar me gjuhën dhe përmbajtjen nuk ofrohet në arsimin e lartë publik (por, sidoqoftë, kjo ofrohet nga disa universitete private.) Kjo nënkupton se investimi i studentëve në zhvillimin e tyre plurilingual ndërpritet, duke përjashtuar rastet kur ata zgjedhin dhe i kanë burimet për të studiuar jashtë vendit. Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të nxisë universitetet të zhvillojnë programe studimi të cilat i mundësojnë studentët të ndjekin studimet akademike pjesërisht në një gjuhë të huaj. Këto programe mund të kenë nevojë për bashkëpunime me universitete të huaja, si edhe rregullime praktike të ngjashme me ato të realizuara për seksionet dygjuhëshe.

4.3 Reforma kurrikulare e gjuhës së huaj dhe teksteve shkollore

Reforma kurrikulare aktuale përfshin një ndryshim nga filozofia e kurrikulës me bazë objektivat në atë me bazë kompetencat. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për arsimin gjuhësor dhe përputhet me mendimet thelbësore të KPERGj dhe PEGj. Zbatimi i suksesshëm do të varet nga qartësimi i kësaj reforme për të gjitha grupet e interesit - mësuesve, prindërve, punëdhënësve, etj. Për këtë qëllim, duhet shqyrtuar mundësia e hartimit të udhëzuesve praktikë lëndorë për mësuesit.

Pjesa 3.4 vëren se përfaqësuesit e prindërve që u takuan me ekspertët e Këshillit të Europës shfaqnin shenja të lodhjes nga reformat. Nga kjo pikëpamje, është e rëndësishme t'u bëhet e qartë të gjitha grupeve të interesit se reformat kërkojnë kohë për të funksionuar deri në nivelet e ulëta të sistemit si niveli i klasës dhe ende më shumë kohë për të dhënë impakt të matshëm.

Pakënaqësia e gjerë me tekstet e hartuara në Shqipëri çoi në futjen e teksteve të huaja më 2005; kjo shënoi një hap të rëndësishëm përpara në përmirësimin e cilësisë. Në të njëjtën kohë, sikurse edhe nënvizohet në pjesën 3.4, është themelore për parimet e Këshillit të Europës që plurilinguizmi të përfshijë edhe gjuhën dhe kulturën amtare të nxënësit. Me përkufizim, materialet e shkruara për tregun ndërkombëtar nuk mundën ta përfshijnë këtë dimension. Kësisoj, mund të jetë me vlerë

³⁰ <http://www.ecml.at/ECML-Programme/Programme2012-2015/ProSign/tabid/1752/Default.aspx>

zhvillimi i udhëzuesve të cilët do t'i ndihmonin mësuesit të shfrytëzonin dhe plotësonin tekstet në një mënyrë të tillë që nxjerr në pah edhe dimensionin shqiptar në mësimin e gjuhëve të huaja.

4.3.1 Mësimi i gjuhës në moshë të hershme

Për arsyet e përmendura në pjesën 3.4.1, nevojat e nxënësve në këtë nivel duhet të jenë përparësi. Me qëllim që këto nevoja të përmbushen, sugjerohet që universitetet pedagogjike duhet të njerrin mësues të cilët kanë një profil që përfshin edhe gjuhët e huaja; po ashtu edhe studentët e fakulteteve të gjuhëve të huaja duhet t'u jepen aftësi dhe njohuri pedagogjike dhe psikologjike të nevojshme për të dhënë mësim në shkollat fillore. Në vijim të këtyre sugjerimeve, duhen shqyrtuar edhe çështjet e ngritura në 3.4.1 si edhe mundësia e kërkimit të mbështetjes së ekspertëve të huaj do të ishte e përshtatshme.

4.3.2 Arsimi profesional

Përparësi duhet t'i jepet mësimdhënies së gjuhëve për qëllime përkatëse profesionale. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka kryer tashmë projekte në këtë fushë: "English for Skills" (në hoteleriturizëm) dhe "English for the World of Work" (në ekonomi dhe TIK). Zhvillime të mëtejshme të dobishme do të ishin përfshirja e gjuhëve të tjera dhe përfitimi nga përvoja e vendeve të tjera të referuara në pjesën 3.4.2.

4.4 Vlerësimi në gjuhën e huaj

Sikurse nënvizohet në pjesën 3.5, kurrikula me bazë kompetencat nënkupton një regjim vlerësimi që përfshin edhe dëgjimin dhe të folurën krahas leximit dhe shkrimit. Është e nevojshme të shqyrtohen rregullime në provimet publike të cilat pasqyrojnë qëllimet e zgjeruara të kurrikulës së re. Në kuadrin e arsimit plurilingual, kjo lidhet edhe me gjuhën shqipe po aq sa edhe me gjuhët e huaja. Një mënyrë për ta trajtuar këtë sfidë, të paktën për një periudhë afatshkurtër, është që përgjegjësia për dëgjimin dhe të folurën t'u jepet shkollave (praktikë që ndodh tanimë në seksionet dygjuhëshe). Por, për periudhën afatgjatë, europinizimi kërkon një formë të re të provimeve publike. Zhvillimet në këtë fushë mund të mbështeten në mjetet dhe burimet e ndryshme të cilat Këshilli i Europës i ofron për të mbështetur përafrimin e vlerësimit gjuhësor me nivelet e zotërimit të KPERGj.

Pjesa 3.5 i referohet nevojës për të ngritur një ekip ekspertësh shqiptarë të testimit dhe vlerësimit gjuhësor. Një mënyrë për të ndërtuar kapacitete në këtë fushë është të rregullohet që të diplomuar të kualifikuar shqiptarë të marrin trajnim në agjensitë e testimit të vendeve të tjera.

4.5 Formimi i mësuesve të gjuhëve të huaja

4.5.1 Formimi fillestar

Në pjesën 4.3.1 sugjerohet që universitetet duhet të orfojnë module të cilat do t'i mundësonin studentët të jepnin mësim gjuhën e huaj në ciklin fillor. Një zhvillim tjetër që vlen të merret në shqyrtim lidhet me modulet e metodologjisë. Nëse ato do të jepen mësim pjesërisht në gjuhët e

huaja të fakultetit, kjo do të sillte një përmirësim të ndjeshëm në cilësi sepse do t'i përgatiste studentët që të përfitonin më me efektivitet nga seminarët e kryera nga ekspertët e huaj në gjuhët respektive.

Duhet shqyrtuar mundësia që të futet përdorimi i portofoleve reflektive në formimin fillestar e mësuesve të gjuhëve të huaja. Struktura e këtyre portofoleve në disa raste mund të përcaktohet nga vetë studenti i mësuesisë duke ndjekur disa udhëzime të përgjithshme dhe në raste të tjera nga fakulteti në fjalë. Do të ishte po ashtu e mundur të përdorej edhe EPOSTEL-i i QEGJM, i cili mund të përshtatet për nevojat e programit specifik të formimit të mësuesve të gjuhëve. Duhet theksuar se EPOSTEL-i është prezantuar tanimë në Universitetin e Elbasanit.

4.5.2 Formimi i vazhduar

Kriteret për zhvillimin profesional të mësuesve përfshijnë edhe kërkesën që ata të kryejnë 18 orë trajnime të vazhduara çdo vit për tri kredite, në vijim të një programi bazuar në një analizë për nevojat e mësuesve. Kjo strukturë nuk ofron gjithësesi një rrugë shumë të qartë zhvillimore. Një risi e mundshme do të ishte të shtohet edhe dimensionin reflektiv për portofolin ekzistues të mësuesit, i cili ka aktualisht tri pjesë: (i) jetëshkrimin ose *curriculum vitae*, (ii) certifikatat e përfituara, dhe (iii) një dosje me lëndët e dhëna mësim (qëllimet, materialet e përdorura, etj.).

Shtimi i një pjese reflektive do t'u mundësonte mësuesve të angazhoheshin në mënyrë kritike me përvojën e tyre pedagogjike gjatë një periudhe të shtrirë kohore.

Një herë në disa vjet, Instituti i Zhvillimit të Arsimit kryen një analizë të nevojave për të përcaktuar përparësitë në formimin e vazhduar të mësuesve. Rezultati i analizës u ofrohet të gjitha agjensive me qëllim që ato të përgatisin module të cilat dërgohen për miratim në këshillin e zhvillimit profesional të MAS. Në të ardhmen, Ministria dëshiron që universitetet të pranojnë të vetëm përgjegjësinë për të zhvilluar module trajnimi për mësuesit. Duhet shqyrtuar edhe mundësia e përfshirjes së studentëve në analizën e nevojave.

Mësuesit kanë nevojë për trajnime të rregullta dhe të strukturuar mirë nëse dëshirojmë që reforma kurrikulare ekzistuese të jetë e suksesshme. Një trajnim i tillë, ofruar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Instituti për Zhvillimin e Arsimit, ofron mundësinë për të njohur mësuesit me udhëzime praktike të llojit të përmendur në pjesën 4.3. Në një tjetër alternativë, udhëzimet mund t'u ofrohen mësuesve nga rrjeti i këshilluesve i ngritur kohët e fundit për të funksionuar në nivel shkollë.

4.5.3 Licensimi i mësuesve

Kapitulli 3 i referohet faktit se provimi i licensimit mbulon të njëjtën fushë njohurish si provimi përfundimtar i studentëve të mësuesisë. Sidoqoftë, ka pasur arsye antikorrupsioni në këtë duplikim. Edhe në këtë kontekst po ashtu do të ishte i dobishëm përdorimi i një portofoli reflektiv si instrument shtesë vlerësimi në licensimin e mësuesve dhe si një mjet dallimi midis dy provimeve. Në këtë portofol studentëve do t'u kërkohet të bëjnë lidhje të qarta midis përvojës së tyre praktike në klasë dhe elementeve shumë më teorike të provimit të licensimit dhe arsimit universitar.

4.5.4 Shoqatat e mësuesve

Duhet shqyrtuar mundësia së vendosjes në një bashkëpunimi midis shoqatave të mësuesve të gjuhëve dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në një bazë më zyrtare përmes një memorandum mirëkuptimi, sikurse sugjerohet në pjesën 3.6.2. Një memorandum i tillë mund të përfshijë në mënyrë të dobishme edhe një dispozitë për bashkëpunim më të madh midis shoqatave të ndryshme. Po ashtu, ai mund të bëhet nxitës që shoqatat të kërkojnë mënyra për të përfituar nga materialet, botimet dhe projektet e QEGjM, si edhe të marrin rol drejtues në promovimin e përdorimit të PEGj në arsimin bazë dhe të mesëm.

4.6 Zhvillimi i cilësisë

Ministria e Arsimit dhe Sportit është e angazhuar për zhvillimin e cilësisë në sistemin arsimor shqiptar në tërësi dhe ka ndërmarrë përpjekje të mëdha në këtë drejtim. Pjesa 3.7 jep disa shembuj të çështjeve të cilësisë të cilat mund të hulumtohen me përfitim edhe më tej. Do të ishte me vlerë të ftoheshin universitetet dhe shoqatat e mësuesve të gjuhëve që të iniciojnë projekte që trajtojnë këto çështje dhe që promovojnë angazhimin e grupeve të interesit në zhvillimin e cilësisë.

4.7 Përmbledhje

Shqipëria është plotësisht e vetëdijshme për rëndësinë e gjuhëve në zhvillimin në të ardhmen prandaj është e angazhuar fuqishëm në zgjerimin e kapaciteteve kombëtare. Përparim i rëndësishëm është bërë që nga fillimi i demokracisë më 1991 në Republikën e Shqipërisë, dhe për gjatë njëzet viteve të fundit europianizimi progresiv i arsimit gjuhësor është ndikuar dhe pjesërisht formësuar nga politika arsimore gjuhësore e Këshillit të Europës dhe instrumentet e ndryshme që janë zhvilluar në mbështetje të asaj politike.

Reforma aktuale e kurrikulës shënon një hap tjetër të rëndësishëm dhe ofron pika kontakti me konceptin e arsimit plurilingual të Këshillit të Europës. Ashtu si edhe në shumë vende të tjera, shumë punë mbetet ende për t'u bërë, sidomos për sa i takon përafrimit të të gjitha gjuhëve të pranishme në një institucion arsimor të caktuar në bashkëveprim të frytshëm me njëra-tjetrën: shqipen si gjuhë shkollimi dhe gjuhë kurrikulare; gjuhët e huaja dhe gjuhët e pakicave të kurrikulës; gjuhët e pakicave që nuk janë pjesë e kurrikulës. Manualet e Këshillit të Europës të renditura në Shtojcën 2 si edhe projektet e ndryshme të Qendrës Europiane të Gjuhëve Moderne ofrojnë një gamë të gjerë mbështetjeje për vendet që duan t'u përgjigjen këtyre sfidave.

Arsimi gjuhësor në Shqipëri ka fatin të mbështetet te një grup mësuesish gjuhësh të angazhuar dhe të trajnuar mirë, te shoqatat e mësuesve të gjuhëve të cilat kanë krijuar lidhje të forta ndërkombëtare dhe te partnerët ndërkombëtarë të cilët kontribuojnë bujarisht në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhëve të tyre në shkollat shqiptare. Me mbështetjen e fortë të këtyre grupeve të interesit dhe mjaft grupeve të tjera, Shqipëria mund të ecë drejt të ardhmes me besim dhe optimizëm.

Shtojca 1 Dokumente që formulojnë qëndrimin e Këshillit të Europës për politikën e arsimit gjuhësor

KONVENTA:

- [European Cultural Convention](#) (1954)
- [European Charter](#) for Regional or Minority Languages [www.coe.int/minlang]
- [Framework Convention](#) for the Protection of National Minorities [www.coe.int/minorities]

REZOLUTA DHE REKOMANDIME PËR POLITIKA:

- **Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës** - www.coe.int/T/CM o Recommendation CM/Rec(2014)5 to member States on the importance of competences in the language(s) of schooling for equity and quality in education and for educational success
 - o Recommendation CM/Rec(2012)13E to member States on ensuring quality education
 - o [Recommendation R \(2008\)7](#) on *The use of the Council of Europe's Common European Framework of Reference for Languages (CEFR) and the promotion of plurilingualism* o [Recommendation R \(98\) 6](#) based on the results of the CDCC Project 'Language Learning for European Citizenship' (1989 – 1996) o [Recommendation R \(82\)18](#) based on the results of the CDCC Project N° 4 ('Modern Languages 1971-1981')
- **Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës** www.assembly.coe.int (*Recommendations are addressed to the Committee of Ministers*) o [Recommendation 2034 \(2014\)](#) on Integration tests: helping or hindering integration?
 - o Recommendation 1740 (2006) on [The place of the mother tongue in school education](#)
 - o Recommendation 1598 (2003) on the protection of [Sign languages](#) in the member states of the Council of Europe
 - o Recommendation 1539 (2001) on the [European Year of Languages 2001](#) o Recommendation 1383 (1998) on [Linguistic Diversification](#) (CM(99)97)
- **Konferenca e Përhershme e Ministrave Europianë të Arsimit** o [Resolution](#) on the *European Language Portfolio* adopted at the 20th Session of the Standing Conference (Krakow, Poland, October 2000)

Këto instrumente dhe rekomandime përbëjnë bazën ligjore dhe politike për politikën arsimore gjuhësore në të gjitha nivelet të cilat jo vetëm lehtësojnë përfundimin e repertorit të varianteve

gjuhësore - diversitetit gjuhësor për individin plurilingual - por gjithashtu garantojnë se do t'i kushtohet vëmendje diversifikimit të opsioneve për mësimin e gjuhës. Kjo e fundit i referohet nevojës për të nxitur dhe lehtësuar mësimin e një game të gjerë gjuhësh dhe jo vetëm kërkesës bashkëkohore për gjuhën angleze.

I kushtohet vëmendje Rekomandimit CM/Rec(2014)5 për gjuhët e shkollimit sepse shumica e kërkesave të mëparshme janë fokusuar kryesisht te gjuhët e huaja/moderne. Është e rëndësishme të përfshihen gjuhët zyrtare/kombëtare në politikat arsimore gjuhësore sepse ato janë pjesë e repertorit gjuhësor të individëve kur këto gjuhë janë gjuhë(-ët) e shkollimit / instruksionit. Në pjesën e tretë të *Udhëzuesit për Zhvillimin e Politikave Arsimore Gjuhësore në Europë*, ([*Guide for the Development of Language Education Policies in Europe*](#)) opsionet për zbatimin e politikave përfshijnë mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhëve kombëtare / zyrtare, të cilat për shumë individë, ose pa dyshim për të gjithë individët, janë gjuhë amtare / e parë.

Shtojca 2 Instrumente të Këshillit të Europës

PËRMBAJTJA E PJSËS

Gjuhët e huaja / moderne (Foreign/Modern Languages)

1. *Kuadri i Përbashkët European i Referencës për Gjuhët: të mësuarit, të nxënës, vlerësimi (KPERGj)*
 - KPERGj dhe provimet gjuhësore: paketa e mjeteve
 - Manuali për lidhjen e provimeve gjuhësore me KPERGj
2. Portofoli European i Gjuhëve (PEGj)

Gjuhët në Arsim, Gjuhët për Arsim (Languages in Education, Languages for Education)

- Faqa e internetit:
 3. Platforma e burimeve dhe referencave për arsimin plurilinguak dhe ndërkulturor
- Botimet kryesore:
 4. *Udhëzues për zhvillimin e politikave arsimore gjuhësore në Europë dhe Studime Referencë përkatëse*
 5. *Udhëzues për zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës për arsimin plurilinguak dhe ndërkulturor, 2016*
 6. *Doracak për zhvillimin e kurrikulës dhe trajnimin e mësuesve. Dimensionin gjuhësor në të gjitha lëndët. 2016*

Këto dokumente dhe burime të tjera janë të disponueshme në faqen e internetit të Programit të Politikës Gjuhësore: www.coe.int/lang si edhe në faqe të dedikuara

GJUHËT E HUAJA / MODERNE

1. *Kuadri i Përbashkët European i Referencës për Gjuhët: të mësuarit, të nxënës, vlerësimi (KPERGj) - (CEFR) www.coe.int/lang-CEFR*

Zhvilluar përmes një procesi kërkimi shkencor dhe konsultimesh të gjera, ky dokument ofron një mjet praktik për përcaktimin e objektivave të qarta për fazat e njëpasnjëshme të mësimin të gjuhës së huaj si edhe për vlerësimin e rezultateve në mënyrë transparente dhe të krahasueshme në rrafsh ndërkombëtar. KPERGj ofron bazën për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve gjuhësore, duke lehtësuar kështu lëvizshmërinë arsimore dhe profesionale. Dokumenti përdoret gjerësisht për reformimin e kurrikulave kombëtare, si edhe nga konsorciumet ndërkombëtare për krahasimin e dëshmimeve gjuhësore. KPERGj përshkruan në një mënyrë tërësore:

- kompetencat e nevojshme për komunikim

- aftësitë dhe njohurinë të lidhur me ato
- situatat dhe fushat e komunikimit

KPERGJ lehtëson përkufizimin e qartë të metodave dhe objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kuadri ofron mjetet e nevojshme për vlerësimin e zotërimit gjuhësor. KPERGJ paraqet interes të veçantë për hartuesit e lëndëve, autorët e teksteve shkollore, testuesve, mësuesve, dhe trajnuesve të mësuesve - në të vërtetë për të gjithë ata që janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në mësimin dhe testimin e gjuhës. Ai ka qenë produkt i punës së gjerë kërkimore dhe të vazhdueshme me objektivat komunikative, sikurse janë të mishëruara nga koncepti popullor i "nivelit fillestar" (threshold level). Suksesi i këtij dokumenti që vendosi standarde ka çuar në përdorimin e gjerë të tij në të gjitha nivelet në Europë dhe në mbarë botën.

KPERGJ ekziston aktualisht në 40 gjuhë të ndryshme.

- Versioni në gjuhën angleze i KPERGJ: *Common European Framework of Reference for Languages: Learning, teaching, assessment*, 2001, Cambridge University Press. ISBN: 0521005310.
- Versioni në gjuhën shqipe: [Kuadri i Përbashkët Europian i Referencës për Gjuhët: Të mësuarit, të nxënët, vlerësimi](#), 2007, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Tiranë.

Një faqe e re interneti e plotë i është kushtuar KPERGJ nga viti 2017 e cila ofron materiale dhe burime të zgjeruara.

→ KPERGJ dhe provimet gjuhësore

KPERGJ shoqërohet nga një numër botimesh mbështetëse të cilat janë të disponueshme në faqen e internetit të Këshillit të Europës, pjesa Burimet ('[Resources](#)').

Për sa i takon ndikimit të veçantë të KPERGJ në vlerësimin gjuhësor, janë zhvilluar një numër mjetesh që janë vendosur në dispozicion të ofruesve të vlerësimit dhe praktikuesve të tjerë të cilët kanë interes në testimet gjuhësore. Shih pjesën: [Tests and Examinations](#)

Pjesa Nivelet ([Levels](#)) përfshin mjete të tilla si materiale që ilustrojnë nivelet e KPERGJ, psh një përmbledhje me raste studimore të përdorimit të KPERGJ, si edhe përshkruesit (deskriptorët) e KPERGJ, si edhe një bankë me përshkrues shtesë.

Pjesa Mësimi, të Nxënët, Vlerësimi ([Learning, Teaching, Assessment](#)) ofron mjete për kurrikulat por edhe burime për përdorimin e KPERGJ në klasë dhe për vlerësim.

→ Lidhja e provimeve gjuhësore me KPERGJ

Manuali për lidhjen e provimeve gjuhësore me Kuadrin e Përbashkët Europian të Rereferencave për Gjuhët (KPERGJ) ([Manual for relating language examinations to the Common European](#)

[Framework of Reference for Languages](#)) është prodhuar nga Njësia e Politikave Gjuhësore me qëllimin për të ndihmuar shtetet anëtare dhe ofruesit kombëtarë/ndërkombëtarë të provimeve për të rakorduar dëshmitë dhe diplomat e tyre me KPERGj.

Objektivi parësor i Manualit është të ndihmojë ofruesit e provimeve të zhvillojnë, aplikojnë dhe raportojnë procedura praktike e transparente në një proces grumbullues të përmirësimit të vazhduar me qëllim pozicionimin e provimit/provimeve të tyre në lidhje me KPERGj.

Manuali mbështetet nga materiale ilustruese (video / DVD dhe CD) për nivelet në një sërë gjuhësh.

Përpos këtyre, manuali plotësohet nga një Supplement Referencë që u ofron përdoruesve të manualit informacion shtesë që i ndihmon ata në përpjekjet e tyre për të lidhur dëshmitë dhe diplomat me KPERGj, si edhe nga Materiale të Mëtejshme ([Further Material](#)) për Ruajtjen e Standardeve për Gjuhët, Kontekstet dhe Administratat duke shfrytëzuar gjykimin e mësuesve dhe shkallëzimin sipas IRT.

Për më tepër, një sërë tabelash analize të përmbajtjes me materiale për të folurën, të shkruarën, dëgjimin dhe leximin janë të disponueshme në internet. [online](#).

2. Portofoli Europian i Gjuhëve (PEGj) - www.coe.int/portfolio

Portofoli Europian i Gjuhëve u zhvillua si mjet për të mbështetur zhvillimin e plurilinguizmit dhe plurikulturalizmit në përputhje me KPERGj. Një sistem akreditimi u ngriti nga Komiteti i Vlerësimit të Këshillit të Europës, i pasuar më vonë nga një sistem regjistrimi: më shumë se 130 modele u vlerësuan deri në dhjetor 2014. Zhvillimi i modeleve të mëtejshme të Portofolit po mbështetet me udhëzime dhe shabllone të disponueshme në faqen e internetit të PEGj.

Cfarë është Portofoli Europian i Gjuhëve?

PEGj është një dokument me anë të të cilit ata që po mësojnë apo kanë mësuar një gjuhë - qoftë në shkollë apo jashtë saj - mund të regjistrojnë dhe të reflektojnë për mësimin e gjuhës dhe përvojës kulturore. Portofoli përmban tri pjesë: i) *Pasaportën e Gjuhës* të cilën zotëruesi e përditëson rregullisht; ii) *një Biografi të detajuar të gjuhës* e cila përshkruan përvojat e zotëruesit me secilën gjuhë dhe iii) *një Dosje* ku ruhen shembujt vetjakë të punës për të ilustruar kompetencat gjuhësore të zotëruesit.

Objektivat

PEGj kërkon të promovojë synimet e Këshillit të Europës. Këto përfshijnë zhvillimin e qytetarisë demokratike në Europë, përmes mbrojtjes dhe promovimit të diversitetit gjuhësor dhe kulturor; promovimit të mësimin ndërkulturor dhe gjuhësor për plurilinguizmin gjatë gjithë jetës;

përshkrimit të qartë dhe transparent të kompetencave dhe kualifikimeve për të lehtësuar koherencën në ofrimin gjuhësor dhe lëvizshmërinë në Europë.

Parimet

Të gjitha kompetencat vlerësohen, qofshin ato të përfituara brenda apo jashtë arsimit zyrtar. Portofoli European i Gjuhëve është pronë e nxënësit dhe është i lidhur me *Kuadrin e Përbashkët European të Referencës për Gjuhët*.

Është rënë dakord për një set me Parime dhe Udhëzime për të gjitha Portofolet (shih faqen e internetit) si edhe janë botuar një numër dokumentesh për të ndihmuar zhvilluesit e tyre.

Faqe e kushtuar e internetit është e strukturuar me dy pjesë, respektivisht të zhvilluara nga instancat e Këshillit të Europës përgjegjëse për praktikën dhe politikën gjuhësore:

- [HARTIMI I NJË PEGJ](#) ► Programi i Politikës Gjuhësore – Strasburg
Kjo pjesë ofron një gamë të gjerë me udhëzime dhe shabllone për të ndihmuar zhvillimin e një PEGJ-i; një panoramë historike; listën e plotë të modeleve të akredituara dhe të regjistruara; përkthimet zyrtare të shkallës globale dhe të tabelës së vlerësimit (34 shkallët e të dëgjuarit; të lexuarit; ndërveprimit të folur; prodhimit të së folurës dhe veprimtari të shkrimit); një bankë me përshkruesit; dhe burime të tjera përfshirë raporte të seminareve për PEGJ.
- [PËRDORIMI I PEGJ](#) ► ECML – Graz
Kjo pjesë ofron një gamë të zgjeruar me burime për përdorimin e PEGJ, si edhe rezultatet e një sërë projektsh.

GJUHËT NË ARSIM, GJUHËT PËR ARSIM

► Faqe interneti

3. Platforma e burimeve dhe referencave për arsimin plurilingual dhe ndërkulturor - www.coe.int/lang-platform

Pas hartimit të dokumenteve referencë si *Kuadri i Përbashkët European i Referencës për Gjuhët* të mësuar si gjuhë "të huaja" (shih pjesën pararendëse), është propozuar një instrument i ri, në formën e një *Platforme*, që do t'i mundësojë shteteve anëtare të përfitojnë nga përvoja dhe ekspertiza e shteteve të tjera anëtare në formulimin e programeve të tyre në lidhje me gjuhët e shkollimit dhe mësimdhënies së të gjitha gjuhëve.

Platforma përbën një burim të hapur dhe dinamik, me një sistem përkufizimesh, pikash reference, përshkrime dhe përshkrues, studime dhe praktika të mira të cilat shtetet anëtare ftohen t'i konsultojnë dhe t'i përdorin në mbështetje të politikës së tyre për të promovuar aksesin e barabartë në arsimin cilësor sipas nevojave, burimeve dhe kulturës arsimore. *Platforma*

përmban disa kuti dhe pjesa më e madhe e tyre (psh. Gjuha/ët e shkollimit apo Gjuha/ët në Lëndët e tjera) kanë lidhje të veçantë me rishikimin e politikave arsimore gjuhësore dhe mund të ofrojnë mbështetje instrumentale për politikbërësit dhe përdoruesit.

Idetë dhe propozimet e parashtruara në Udhëzues dhe të përshkrura në pjesën e mëposhtme janë pjesë e projektit të Njesisë së Politikës Gjuhësore të Këshillit të Europës "Gjuhët në arsim - gjuhët për arsim", dhe kontributet në të janë të botuara në *Platformë*.

➤ **Botimet kryesore**

4. Nga diversiteti gjuhësor te arsimit plurilingual: Udhëzues për zhvillimin e politikave arsimore gjuhësore në Europë

Qëllimi i Udhëzuesit është të ofrojë një instrument analitik që të shërbejë si dokument reference për formulimin dhe riorganizimin e mësimdhënies së gjuhës në shtetet anëtare. Qëllimi i tij është të japë një kundërpërgjigje për nevojat në formulimin e politikave gjuhësore për promovimin e plurilinguizmit dhe diversifikimit në një mënyrë të planifikuar me qëllimin që vendimet të jenë të lidhura në mënyrë koherente. Udhëzuesi trajton, psh. specifikimin e parimeve dhe objektivave udhëzuese, analizimin e burimeve dhe situatës konkrete, pritshmëritë, nevojat, zbatimin dhe vlerësimin. Në të njëjtën mënyrë, Udhëzuesi nuk promovon një politikë të caktuar arsimore, por rreket të identifikojë sfidat dhe kundërpërgjigjet e mundshme në përputhje me parimet e përbashkëta.

Për këtë arsye Udhëzuesi është i organizuar në tri pjesë:

- Analiza e politikave arsimore gjuhësore aktuale në Europë (karakteristikat e përbashkëta të politikave të shteteve anëtare dhe paraqitja e parimeve të Këshillit të Europës)
- Informacioni i kërkuar për formulimin e politikave arsimore gjuhësore (metodologjitë për hartimin e politikave, aspektet / faktorët që duhen marrë parasysh në vendim-marrje)
- Zbatimi i politikave arsimore gjuhësore (parimet drejtuese dhe opsionet e politikave për vendim-marrësit në ofrimin e diversifikimit në zgjedhjen e gjuhëve të mësuara si edhe në promovimin e kompetencës plurilinguale; inventarin e mjeteve teknike si edhe përshkrimin e secilës 'zgjidhje' me treguesit e kostos, kohës prezantuese, mjeteve, implikimeve për trajnimin e mësuesve, administrimin, etj.)

Me qëllim që propozimet e parashtruara këtu të jenë të disponueshme për lexuesit me nevoja të ndryshme, *Udhëzuesi për Zhvillimin e Politikave Arsimore Gjuhësore në Europë* është i disponueshëm në dy versione për t'iu përshtatur nevojave të grupeve specifike të lexuesve:

- **Versioni Kryesor** (versioni referencë), i cili shtjellon, argumenton dhe jep shembuj të të gjitha parimeve, analizave dhe qasjeve për organizimin e politikave arsimore gjuhësore europiane,

sikurse ato janë konceptuar në kuadrin e Këshillit të Europës. Ky version është hartuar për të gjithë lexuesit e interesuar për të gjitha aspektet e këtyre çështjeve, përfshirë edhe dimensionin teknik. Ai ofron mjetet për t'i kthyer përgjigje pyetjes: *Si mund të prezantohen në të vërtetë politikat arsimore gjuhësore të përshtatura për plurilinguizmin?* Ky version në vetvete është i zgjeruar me një seri prej 21 Studimesh Referencë ([Reference Studies](#)) të cilat janë prodhuar posaçërisht për Udhëzuesin nga specialistë në fushat përkatëse. Ato janë botuar më vete dhe përbëjnë një sintezë të çështjeve të trajtuara në këtë version ose i marrin ato me detaje më të hollësishme.

- **Versioni Ekzekutiv** është shkruar për ata të cilët ndikojnë, formulojnë dhe zbatojnë politika arsimore gjuhësore në çdo nivel, psh, në institucione të veçanta, në qeverisje vendore, në sistemin arsimor kombëtar apo në institucione publike dhe private ndërkombëtare. Ky dokument nuk është për specialistët gjuhësorë por për politikëbërësit të cilët mund të mos kenë njohuri të specializuara të caktuara në çështjet teknike të arsimit gjuhësor.

5. Udhëzues për zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës për arsimin plurilingual dhe ndërkulturor. 2016

Ky Udhëzues ([Guide](#)) synon të lehtësojë zbatimin e përmirësuar të vlerave dhe parimeve të arsimit plurilingual dhe ndërkulturor në mësimdhënien e të gjitha gjuhëve - të huaja, rajonale apo të pakicave, klasike, si edhe gjuhëve të shkollimit.

Teksti përmban tre kapituj. Kreu i parë paraqet një panoramë të përgjithshme të çështjeve dhe parimeve të lidhura me hartimin dhe / ose përmirësimin e kurrikulës, si edhe të qasjeve pedagogjike dhe didaktike të cilat hapin udhën për një realizim më të plotë të qëllimeve të përgjithshme të arsimit plurilingual dhe ndërkulturor. Dy krerët pasues hedhin një vështrim më të thelluar në dy çështje themelore të ngritura në kreun e parë: Si mund të identifikohen dhe integrohen në kurrikul përmbajtja specifike dhe objektivat e arsimit plurilingual dhe ndërkulturor, duke respektuar njëkohësisht edhe përmbajtjen specifike dhe objektivat e mësimdhënies së gjuhëve specifike? Si mund të përdoren skenaret kurrikulare për të projektuar vendosjen në hapësirën kohore të kësaj përmbajtjeje dhe të këtyre objektiveve? Në përfundim, disa shtojca ofrojnë mjetet dhe listat e referencave. Të gjitha këto mund të plotësohen duke u konsultuar me materialet mbështetëse të disponueshme në platformën në fjalë.

ISBN. 978-92-871-8234-0. I disponueshëm në internet [online](#) në anglishte, frëngjishte dhe italishte.

6. Një Manual për Zhvillim Kurrikule dhe Trajnim Mësuesish. Dimensioi Gjuhësor në të Gjitha Lëndët. 2016

Zotërimi i gjuhës së shkollimit është thelbësor për nxënësit që të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për sukses në shkollë dhe për mendim kritik. Ai është thelbësor për pjesëmarrjen në shoqëritë demokratike, si edhe për përfshirje dhe kohezion shoqëror.

Ky manual është një dokument politike dhe pune që promovon konvergencën dhe koherencën midis dimensioneve gjuhësore të lëndëve të ndryshme shkollore. Ai propozon masa për të bërë të qarta - në kurrikul, në materialet pedagogjike dhe trajnimet e mësuesve - normat dhe kompetencat specifike gjuhësore që nxënësit duhet të zotërojnë në çdo lëndë shkollore. Ai gjithashtu paraqet modalitetet mësimore të cilat do t'i lejonin të gjithë nxënësve dhe veçanërisht atyre më të cënuarve midis tyre, të përfitonin nga situatat e mësimi të diversifikuar të gjuhës me qëllim që të zhvillojnë kapacitetet e tyre konjitive dhe gjuhësore.

ISBN 978-92-871-8456-6. I disponueshëm në internet [online](#) në anglishte dhe frëngjishte.

Mësimi i integruar me gjuhën dhe përmbajtjen (CLIL)

Gjuhët e huaja përdoren si gjuhë mësimi në seksionet dygjuhëshe të shkollave të mesme dhe në takimin e tyre me ekspertët e Këshillit të Europës, përfaqësuesit e shoqatave të prindërve shprehën interes të madh për zgjerimin e mësimnxënies së integruar në shkolla në përgjithësi. Një mënyrë për të ecur përpara në këtë drejtim mund të jetë futja e një skeme për trajnimin e veçantë të mësuesve e cila do të shfrytëzonte faktin se një gjuhë e huaj është pjesë e detyruar e kurrikulës universitare për studentët në të gjitha fakultetet, duke krijuar kështu një kontigjent me mësues shqiptarë të aftë për të dhënë mësim në disa lëndë në gjuhën e huaj të zgjedhur prej tyre.

Investimi i Shqipërisë në seksionet dygjuhëshe të shkollave të mesme dhe në mësimdhënien e integruar (CLIL) ngre pyetjen: Me sa efektivitet i përdor dhe i ndërton më tej arsimit të lartë kompetencat në gjuhë të huaj të zhvilluara në shkollë? Në sektorin privat është e mundur të marrësh një diplomë të përbashkët, kryesisht në shqipe dhe italishte; ndoshta universitetet publike duhet të nxiten të ofrojnë programe dygjuhëshe në shqip/anglisht, shqip/frëngjisht, shqip/gjermanisht dhe shqip/italisht. Futja e këtyre programeve do ta përmirësonte cilësinë e ofrimit të arsimit të lartë si edhe do të zgjeronte gamën e mundësive të ofruara për studentët.

3.4 Reforma kurrikulare në gjuhët e huaja dhe tekstet

Fusha arsimore e gjuhëve të huaja ka qenë në një situatë reformimi pak a shumë të vazhdueshëm që nga mesi i viteve 1990-të. Në vitin 2000, Ministria e Arsimit dhe Sportit miratoi futjen e kurrikulës kombëtare me bazë përmbajtjen, e cila u zëvendësua më 2005 nga kurrikula me bazë objektivat, që aktualisht po zëvendësohet nga kurrikula me bazë kompetencat. Përfaqësuesit e prindërve që u takuan me Grupin e Ekspertëve shfaqnin dukshëm një lodhje nga reformat, dhe nga diskutimet me mësuesit, ekspertët nuk ia dolën të nxirrin qartë se në çfarë mase reformat e njëpasnjëshme kurrikulare kanë çuar në ndryshimin e mësimin në klasë. Sipas Raportit Vendor, reforma kurrikulare në gjuhët e huaja është udhëhequr nga *Kuardi i Përbashkët European i Referencës për Gjuhët* që nga përkthimi i këtij dokumenti më 2007.¹ Kjo reflektohet qartë në orientimin e përgjithshëm të reformës në vijim. Megjithatë, statet e mëtejshme të reformës mund të kenë më shumë përfitime nga një reflektim më i thellë i ndikuar jo vetëm nga KPERGj, por edhe nga dokumentet e tjera të hartuara nga Programi i Politikës Gjuhësore.²⁸ Dokumenti i botuar së fundmi, *Udhëzues për Zhvillimin dhe Zbatimin e Kurrikulave për Arsimin Plurilinual dhe Ndërkulturor* (2016), për shembull, ofron udhëzime dhe burime të cilat mund të jenë veçanërisht të dobishme.

Është e rëndësishme të pranojmë se reforma kurrikulare ka - ose duhet të ketë - pasoja të rëndësishme në praktikën pedagogjike. Tek e fundit, është një udhë e gjatë nga mësimdhënia gramatikë-përkthim dhe vlerësimi drejt mësimdhënies, strategjive dhe standardeve të

¹ [*Kuadri i përbashkët european i referencës për gjuhët: të mësuarit, të nxënë, vlerësimi*](#)

²⁸ Shih Shtojcën 2 (pjesën 5).

vlerësimin të cilat fokusohen te zhvillimi i kompetencave të nxënësit. Qasja me bazë kompetencat është mjaft e ndërlikuar dhe presupozon një të kuptuar të thelluar të parimeve social-konstruktiviste të mësimin të gjuhës dhe implikimet e tyre për rolin e mësuesve dhe nxënësve. Kjo ngre pikëpyetje të rëndësishme për natyrën e njohurisë ("kompetencën") që mësimdhënësia e gjuhës duhet të kërkojë dhe zbatimin e suksesshëm të kësaj qasjeje varet nga nxënësit që mësojnë dhe shfrytëzojnë strategjitë dhe aftësitë për mësimin e gjuhës. Me fjalë të tjera, reforma kurrikulare aktualisht në vijim ka nevojë për një rishqyrtim kritik të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimin të gjuhës në të gjitha nivelet e sistemit arsimor. Kjo do të ketë ndikim të thellë edhe te formimi i mësuesve të gjuhës.

Miratimi i kurrikulës me bazë kompetencat është qartësisht në përputhje me dëshirën për t'i pajisur qytetarët me aftësitë të cilat u nevojiten atyre për të pasur sukses në një Europë multikulturale gjithnjë e më konkurruese. Kjo dëshirë mund të shpjegojë gjithashtu vendimin për të përdorur tekste shkollore të prodhuara për tregun ndërkombëtar nga botues të huaj. Këto tekste shkollore kanë avantazhin e pamohueshëm se janë të shkruara nga folës amtarë të gjuhës në fjalë, por nuk ka garanci se ato janë të përshtatura për një model me bazë kompetencat. Sidoqoftë, parimet e plurilinguizmit dhe ndërkulturalizmit kërkojnë që mësimi i gjuhës së huaj të marrë parasysh interesat dhe pritshmëritë e nxënësve në kontekstin e tyre kulturor. Materialet e shkruara nga folësit amtarë për tregun ndërkombëtar mund të ofrojnë origjinalitetin e folësit amtar dhe mund të pasurojnë të kuptuarin e studentëve për kulturën e bashkësive të gjuhës së synuar, por ato nuk mund të marrin në konsideratë kontekstin kulturor shqiptar në lidhje me gjuhën e synuar. Është thelbësore për parimet e Këshillit të Europës që plurilinguizmi dhe multikulturalizmi të përfshijnë edhe gjuhën dhe kulturën e vetë nxënësit.

Sistemi kurrikular shqiptar - kuadri i përgjithshëm, programet lëndore, direktivat për zbatimin e përgjithshëm dhe direktivat për lëndë të veçanta - nuk shkon deri në nivelin e ulët të planifikimit dhe vlerësimin (njësitë mësimdhënëse dhe mësimet) në shkolla. Një mënyrë për ta ndrequr këtë mangësi do të ishte që t'u jepej fuqi mësuesve të gjuhëve të përcaktonin kurrikula me bazë kompetencat specifike për shkollën: plane pune që synojnë të pasurojnë veprimtaritë e bazuara te tekstet duke shtuar kontekstin social kulturor përkatës. Shkollave mund t'u ofrohet një tabelë e përbashkët për të zhvilluar plane pune si edhe një manual që shpjegon se përse është e mirë tabela dhe si ta përdorin atë. Me kohë, nga mësuesit mund të pritët të bazojnë (le të themi) 70% të mësimdhënies së tyre në tekste shkollore me materiale mësimore të krijuara paraprakisht dhe pjesa tjetër me materiale të përshtatura për kontekstin shqiptar. Këto rregullime do të ishin plotësisht të harmonizuara me strukturën e sistemit arsimor: kurrikula përcaktohet në nivelin qendror, çështjet administrative trajtohen në nivel vendor dhe cilësia e mësimdhënies është përgjegjësi e shkollës përkatëse.

3.4.1 Mësimdhënësia e gjuhës në moshë të hershme

Në Shqipëri, pjesa dërrmuese e nxënësve e fillojnë mësimin e gjuhës së parë të huaj në klasën III të shkollës fillore. Kjo ishte rezultat i një përpjekjeje reformuese kryesore që u realizua në një periudhë kohore, për të cilën autoritetet shqiptare meritojnë vlerësimin më të lartë.

Ndonëse grupi i ekspertëve nuk vizitoi ndonjë orë mësimore të gjuhës së huaj në shkollën fillore, vëzhgimet e mëposhtme duket se janë të përshtatshme. Gjatë dy dekadave të fundit, shumë vende europiane kanë futur mësimin e gjuhës së huaj në moshë të hershme dhe përvoja ka treguar se qasjet pedagogjike të përshtatshme për fëmijët midis moshës 6 dhe 10/11 vjeç ndryshojnë në një sërë mënyrash nga qasjet e përdorura përgjithësisht në asrimin e mesëm të ulët. Kjo ngre tri çështje për autoritetet shqiptare. Së pari, çfarë lloj formimi fillestar për mësuesit dhe mentorimi pasues me bazë detyrat nevojiten me qëllim që të përcakohet një profil profesional specifik për mësuesit e gjuhës së huaj në nivelin fillor? (Minimalisht profili duhet të përfshijë një nivel të lartë të zotërimit të gjuhës së huaj përkatëse dhe një njohuri të thelluar të zhvillimit psiko-social të nxënësve të vegjël.) Së dyti, a duhet të ftohen ekspertë nga vende të tjera europiane me përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies në moshë të hershme për të mbështetur një program për kurse pa shkëputje nga puna për mësuesit e gjuhëve të cilët janë të kualifikuar për mësimdhënie në nivelin e mesëm të ulët? (Vlen të nënvizohet në këtë pikë se disa projekte të fundit të QEGJM kanë zhvilluar instrumente dhe burime për mbështetjen e mësimdhënies në moshë të hershme.) Dhe së treti, si mund t'u ofrohen tekste dhe materiale mësimdhënieje shkollave të përshtatura për nevojat e nxënësve të vegjël?

3.4.2 Gjuhët e huaja në arsimin profesional

Në shkollat e mesme profesionale, gjuhët e huaja mësohen me dy objektiva në mendje: për të përgatitur nxënësit për arsimin e lartë në pothuajse të njëjtën mënyrë si llojet e tjera të shkollave të mesme dhe për të zhvilluar aftësitë e nevojshme për tregun e punës si në rastin e programit "English for Skills" të Këshillit Britanik, i cili mësohet për katër muaj para provimit të Maturës Shtetërore. Një problem që ndeshet nga mësuesit e gjuhës së huaj në këtë fushë është fakti se përgjegjësia është e ndarë midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale; një tjetër problem është prirja e raportuar se mësimi të gjuhëve i jepet përparësi vetëm në fushën e menaxhim-turizmit dhe TIK. Sistemet e tjera arsimore në Europë kanë ndeshur në probleme të ngjashme me ato që po ndesh Shqipëria. Zgjidhja e tyre ka qenë zhvillimi i strategjive praktike dhe të forta për të harmonizuar kërkesat e arsimit të përgjithshëm dhe profesional duke e riorganizuar kuadrin kurrikular dhe sistemin e provimeve nën një ministri si edhe përfshirjen e ministrive dhe agjensive të tjera (dhomat e tregtisë, punëdhënësit, sindikatat) në procesin e vendim-marrjes dhe zhvillimin e programeve lëndore për fushat lëndore përkatëse. Shembuj mund të gjenden në Austri, Gjermani dhe Hollandë.

3.5 Vlerësimi në gjuhën e huaj

Provimi i Lirimit kryhet në fundin e arsimit të detyruar në mbarim të klasës IX dhe Provimi i Maturës Shtetërore në përfundim të shkollës së mesme. Për të gjitha lëndët, të dy provimet kanë nga 13 pyetje me alternativa dhe 12 pyetje të hapura; provimet zgjasin përkatësisht dy orë dhe dy orë e gjysmë. Provimi i Lirimit është i shkallës së ulët sepse rezultatet e tij nuk kanë ndikim në frekuentimin e nivelit pasues arsimor, ndërsa Matura Shetërore është e shkallës së lartë sepse rezultatet e saj kanë impakt të drejtpërdrejtë në arsimimin e mëtejshëm dhe në mundësitë e karrierës në të ardhmen. Në gjuhët e huaja, të dy provimet përqendrohen

ekskluzivisht në lexim dhe shkrim. Kjo do të thotë se ato nuk mund të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme mësimin që një kurrikul me bazë kompetencat synon të promovojë. Kjo është një sfidë kryesore për sistemin shqiptar. KPERGj i ndërthur sëbashku kurrikulën, të mësuarit/nxënit dhe vlerësimin në ndërvarësi më të ngushtë se ato kanë qenë tradicionalisht më parë. Me qëllim që të përmbushë ambicjen e kurrikulës me bazë kompetencat, Shqipëria ka nevojë të angazhohet për ndërtimin afat-gjatë të kapaciteteve në testimin dhe vlerësimin e gjuhës.

Sipas Raportit Vendor, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjensia Kombëtare e Provimeve kanë vendosur të ofrojnë teste të huaja për zotërimin e gjuhës si pjesë e Provimit të Lirimit dhe Maturës Shtetërore. Kur zhvillohen në Europë këto lloj testesh rakordohen me KPERGj dhe një argument në favor të tyre është se ato do të mbështesin certifikimin në pajtim me standardet e kërkuara për pranimin në universitete të huaja. Seksionet shkollore dygjuhëshe në frëngjisht, italisht dhe gjermanisht tanimë përdorin teste nga Franca, Italia dhe Gjermania, por ky është rast i veçantë. Suksesin në testimin e gjuhës frënge, italiane dhe gjermane u mundëson studentëve shqiptarë të garojnë për një vend në universitet në Francë, Itali dhe Gjermani në nivel të barabartë me bashkëmoshatarët e këtyre vendeve. Sidoqoftë, për sa i takon sistemit arsimor shqiptar në përgjithësi, i njëjti argument vlen për testet e huaja sikurse është përdorur në seksionin 3.4 për tekstet e huaja. Në thelb, një kurrikul shqiptare kërkon një vlerësim shqiptar, dhe nxënësit që përfundojnë shkollën duhet të kenë mundësinë të bëjnë një test vlerësimi të arritjeve të tyre të bazuar fort në kurrikulën me të cilën ata kanë studiuar.

3.6 Formimi i mësuesve të gjuhëve të huaja

Sipas Raportit Vendor, afërsisht 700 studentë pranohen në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja çdo vit (ky numër përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit). Deri në vitin 2016-2017 fakulteti nuk i përcaktonte kriteret e pranimit të studentëve, të cilët mund të regjistroheshin edhe pa e njohur gjuhën përkatëse. Kjo shkaktoi shqetësime serioze në cilësinë e studentëve të rregjistruar dhe kontribuoi në shkallën e lartë të moskalueshmërisë. Kur stafi akademik i fakultetit u takua me ekspertët e Këshillit të Europës, ata argumentuan se studentët duhet të pranohen vetëm nëse ata kanë një nivel B1 të certifikuar të zotërimit të gjuhës së përzgjedhur. Grupi i ekspertëve beson se do të ishte e duhur të kërkohet një nivel më i lartë zotërimi i gjuhës për pranimin në nivelin pasuniversitar të studimeve (ciklin master) në mësimdhënien e gjuhës së huaj.

Arsimi universitar është përgjithësisht akademik jo profesional nga natyra. Kjo shpjegon pse në shumë vende formimi i mësuesve është përgjegjësi e njëjësive të specializuara, shpesh të vendosura në universitete. Në Shqipëri, formimi fillestar i mësuesve është i vendosur në një trajktore arsimore të përcaktuar nga procesi i Bolonjës. Duhet të shqyrtohet mundësia e zhvillimit të një programi trajnimi pasuniversitar për mësuesit i menaxhuar nga akademikë me përvojë të mëparshme në mësimdhënien shkollore / ose me përfshirje të vijueshme në kërkimet me bazë shkollë apo zhvillimin profesional. Me një program të tillë, do të ishte e nevojshme të bëhen përgatitje më vete për nivelet e ndryshme të arsimit parauniversitar. Sikurse është

thënë në pjesën 3.4.1, përdorimi i mësuesve të trajnuar në pedagogjinë e arsimit të mesëm të ulët për të dhënë mësim për nxënësit e vegjël, kjo shpërfill nevojat specifike të fëmijëve dhe mund të ketë lehtësisht efekt negativ për suksesin e mësimdhënies në moshë të hershme. Faktorë të tjerë specifikë për përmbajtjen që duhen shqyrtuar kur hartohet kurrikula për formimin e mësuesve, përfshijnë procedurat për mësimdhënien me klasa të mëdha dhe/ose me nivele të përziera, praktika përsiatëse, dhe promovimi i formave të ndryshme kërkimore për mësuesit.

3.6.1 Përzgjedhja, vlerësimi dhe mbajtja e mësuesve të gjuhëve të huaja

Nevoja për mësues të gjuhëve me cilësi të lartë në të gjitha nivelet e sistemit është një argument për kërkimin e nivelit minimal të zotërimit për pranimet në programet e ciklit të parë dhe të dytë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Pas tri vite studimesh universitare dhe dy vite pasuniversitare, mësuesve të mundshëm u kërkohet të shpenzojnë një vit shtesë si praktikantë në një shkollë. Mundësitë për mentorim janë të kufizuara dhe duket se disa të diplomuar nuk kanë mundësi të gjejnë një shkollë ku të mund të punojnë. Ata që kalojnë provimin e licensimit dhe akreditimit në përfundim të periudhës së mentorimit, listohen për arsye punësimi. Kjo masë është futur së fundmi në dobi të transparencës dhe për të eliminuar korrupsionin.

Për sa i takon vlerësimin për akreditimin, grupi i ekspertëve beson se duhet të shqyrtohet në mënyrë të dobishme futja e një portofoli reflektues që mund të përfshijë mendimet e nxënësve dhe mentorëve, si edhe raportin dhe angazhimin kritik të vetë praktikantit për përvojën e tij gjatë periudhës së mentorimit.